EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5690
E enjte, 31 janar 2019
çmimi 0.40 €

Më 2 shkurt seanca për buxhetin

FAQE 9

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIDERËT E KOALICIONIT QEVERISËS JANË TAKUAR TË MËRKURËN PËR TË BISEDUAR PËR ZHVILLIMET E FUNDIT NË VEND FAQE 4-5

Qeveria vazhdon, taksa nuk pezullohet

Udhëheqësit e koalicionit qeverisës janë pajtuar të mërkurën që koalicioni qeverisës ta vazhdojë punën. Pas një takimi dyorësh, i cili është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë, është diskutuar për zhvillimet e fundit politike dhe për taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Ata janë zotuar për shtimin e hapave dhe për bashkërendimin e vendimeve me partnerët strategjikë të Kosovës, ShBA-në dhe BE-në. Vlerësim i përbashkët i tyre ishte, sipas një deklarate të Zyrës së Kryeministrit, se koalicioni është stabil dhe me më përkushtim do të vazhdojë drejt arritjes së objektivave

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së, pas kompletimit të dokumentacionit

Emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga presidenti Hashim Thaçi pritet të ndodhë së shpejti. Zyra për Informim e Presidentit nëpërmjet një përgjigje me shkrim për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se emërimi i anëtarëve të KQZ-së do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit të tyre meqë ka pasur dokumentacione të pakompletuara të disa prej të nominuarve. Por, kandidati për anëtar të KQZ-së nga radhët e LDK-së, Florian Dushi, ka thënë se presidenti është duke vepruar në kundërshtim me rolin dhe përgjegjësitë e veta kushtetuese FAQE 3

SBAShK-u: Koeficientët janë të papranueshëm, greva vazhdon

FAQE 7

AKTUALE

NUK KA SKENARË TË MIRË ME SKENARISTË TË KËQIJ

F. 6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

MUSTAFA: KOSOVA E KA ZBATUAR NË MËNYRË TË SUKSESSHME STRATEGJINË PËR ARMËT

F. 2

ZAHIRI, HAKIFI DHE EDMONDI DËSHMUAN SE SHQIPTARËT NUK MUND TË MPOSHTEN NË PËRPJEKJET PËR LIRI

F. 5

EKONOMI

RRITET NUMRI I PASAGJERËVE QË SHFRYTËZOJNË TRENIN DHE AEROPLANIN

F. 8

NUMRI I BIZNESEVE NË KOSOVË SHËNON RRITJE

F. 8

KULTURË

Intervistë me Meriman Brahën (2)

NË GOLI OTOK, DËNIME MË TË RËNDA SE NË KAMPET NAZISTE

F. 13

SPORT

BYTYQI: KOSOVA PËR SHUMË VJET E KA PORTËN E SIGURT

F. 16

MIQËSORJA KOSOVË - DANIMARKË, MË 21 MARS NË 'FADIL VOKRRI'

F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Maqedonia e Veriut, qeveria flet shqip!

Shkup, 30 janar - Qeveria e Maqedonisë ka nisur procedurat për fillimin e zbatimit në praktikë të Ligjit për përdorimin e gjuhëve, përkatësisht të gjuhës shqipe. Zëdhënësi i Qeverisë së këtij shteti, Muhamet Hoxha, ka thënë se në mbledhjen e së mërkurës të kabinetit qeveritar, ministrat shqiptarë për herë të parë i kanë mbajtur fjalimet e tyre në gjuhën shqipe.

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka theksuar se me përdorimin e gjuhëve të bashkësive etnike, mundësohet zgjidhja ligjore që në të njëjtën kohë paraqet shembull për përkushtimin e institucioneve që jo vetëm në mënyrë deklarative, por edhe në praktikë t'u mundësohet bashkësive etnike e drejta e përdorimit të gjuhës së tyre.

Qeveria, gjithashtu, ka marrë vendim për nisjen e procedurës për zbatimin në praktikë të emrit të ri të shtetit, "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Në të gjitha institucionet e nivelit qendror, si në objektin e Qeverisë, të ministrive, Kuvendit, vendkalimet kufitare e organe tjera, tabelat do të duhet të zëvendësohen me emrin e ri të shtetit, ndërsa një hap i tillë do t'iu rekomandohet edhe institucioneve të pushtetit lokal. Tabelat do të jenë edhe në gjuhën shqipe, ashtu siç është e rregulluar me ligj.

Vendimet e Qeverisë në Shkup janë marrë disa ditë pasi Kuvendi i Greqisë ka ratifikuar marrëveshjen për zgjidhjen e kontestit 27-vjeçar të emrit.

Marrëveshja e arritur më 17 qershor të vitit të kaluar ka zhbllokuar procesin e anëtarësimit të Maqedonisë në NATO si dhe pritet të rezultojë me nisjen e bisedimeve për anëtarësimin e këtij vendi në Bashkimin Evropian.

Mustafa: Kosova e ka zbatuar në mënyrë të suksesshme strategjinë për armët

> Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, tha se janë duke u adresuar të gjitha posedimet e paligjshme të armëve dhe, përveç konfiskimit, është duke u zbatuar edhe një aktivitet për legalizim, me qëllim që t'ua ofrojë mundësinë të gjithë qytetarëve që të jenë në pajtim me ligjin si dhe ta rrisin sigurinë në Kosovë

Prishtinë, 30 janar - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme u mbajt takimi i Bordit të Projektit të UNDP-së për Siguri (KSSP) në Kosovë. Në këtë takim morën pjesë ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, Alessandra Roccasalvo, përfaqësuese e përhershme u. d. e UNDP-së, ambasadori norvegjez Per Strand Sjaastad, ambasadori gjerman Christian Heldt dhe drejtori për Operacione në Policinë e Kosovës, Afrim Ahmeti.

Bordi shqyrtoi rezultatet e projekteve të arritura gjatë vitit 2018 dhe u diskutuan nevojat për asistencë të mëtutjeshme që do të kontribuojnë për rritjen e sigurisë së përgjithshme në Kosovë. Me këtë rast, ministri Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, falënderoi projektin e UNDP- së për Siguri në Kosovë, i cili ka ndihmuar për gati 10 vjet, jo vetëm në fushën e kontrollit të armëve të vogla, por edhe në kontekstin më të gjerë të çështjeve të sigurisë, përfshirë tani edhe në fushën e sigurisë kibernetike. "Kosova e ka zbatuar në mënyrë të suksesshme Strategjinë për armët e vogla dhe të lehta dhe planin e veprimit që nga viti 2009. E ka miratuar planin e veprimit me Udhërrëfyesin për zgjidhje të qëndrueshme rreth posedimit ilegal, keqpërdorimit dhe trafikimit të armëve të vogla dhe të lehta dhe municionit të tyre në Ballkanin Perëndimor deri më 2024. Udhërrëfyesi është pjesë e Procesit të Berlinit", theksoi ministri Mustafa.

Ministri Mustafa theksoi se janë duke u adresuar të gjitha posedimet e paligjshme dhe, përveç konfiskimit, është duke u zbatuar edhe një aktivitet për legalizim, me qëllim që t'ua ofrojnë mundësinë të gjithë qytetarëve të jenë në pajtim me ligjin si dhe, në anën tjetër, të rrisin sigurinë në Kosovë. "Duke e parë rrezikun në rritje nga krimi kibernetik, si dhe sigurinë online të qytetarëve tanë, do të doja ta falënderoja Projektin e UNDP-së për siguri, gjithashtu edhe për projektin në këtë fushë", tha ministri Mustafa.

Në fund ai falënderoi donatorët: Qeverinë e Gjermanisë, Norvegjisë, Italisë, si dhe USAID-in për ndihmën e tyre në të dy fushat, si dhe për mbështetjen që na e kanë dhënë për t'u bërë eksportues të sigurisë.

Projekti KSSP-së është plotësisht i integruar në kuadër të institucioneve përkatëse dhe mbështet zhvillimin e aplikueshëm të kornizës ligjore, strategjitë dhe planet e veprimit. Mbrojtja dhe siguria publike janë parakushte për zhvillim të qëndrueshëm dhe arritjen e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OZHQ-ve), posaçërisht OZHQ 16. Projekti është i fokusuar në kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL), zhvillim më të sigurt të komunitetit, parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe, kohën e fundit, edhe në luftimin e krimit kibernetik.

Meta përshëndet marrëveshjen e partive shqiptare në Mal të Zi

Tiranë, 30 janar - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka përshëndetur të mërkurën marrëveshjen e partive shqiptare në Mal të Zi, të cilat kanë formuar një koalicion të përbashkët për zgjedhjet lokale në komunën e Tuzit. "E përshëndes vendimin e mençur të udhëheqësve të subjekteve politike shqiptare në Malin e Zi për arritjen e marrëveshjes për formimin e një koalicioni të përbashkët parazgjedhor për zgjedhjet lokale të 3 marsit në Komunën e Tuzit. Duke u uruar suksese në këtë garë elektorale, jam besimplotë se kjo marrëveshje është një hap në drejtimin e duhur për fitoren dhe drejtimin e Komunës së Tuzit përmes bashkëpunimit por edhe bashkëjetesës shembullore me malazezët dhe me të gjithë grupimet e tjera etnike", ka shkruar presidenti Meta.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti Hashim Thaçi është në pritje të dokumentacionit shtesë për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

Emërimi i anëtarëve të KQZ-së pas kompletimit të dokumentacionit

Emërimi i anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga presidenti Hashim Thaçi pritet të ndodhë së shpejti. Zyra për Informim e Presidentit nëpërmjet një përgjigje me shkrim për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se emërimi i anëtarëve të KQZ-së do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit të tyre, meqë ka pasur dokumentacione të pakompletuara të disa prej të nominuarve. Por, kandidati për anëtar të KQZ-së nga radhët e LDK-së, Florian Dushi, ka thënë se presidenti është duke vepruar në kundërshtim me rolin dhe përgjegjësitë e veta kushtetuese

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

Prishtinë, 30 janar - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pritet të bëhet funksional së shpejti meqë presidenti i vendit, Hashim Thaçi, në ditët në vazhdim do t'i emërojë anëtarët e rinj të KQZ-së. Zyra për Informim e Presidentit nëpërmjet një përgjigje me shkrim për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se emërimi i anëtarëve të KQZ-së do të bëhet pas kompletimit të dokumentacionit të tyre meqë ka pasur dokumentacione të pakompletuara te disa prej të nominuarve. "Pas pranimit të nominimeve nga grupet parlamentare për anëtarë të KQZ-së dhe verifikimit të dokumentacionit të tyre, Departamenti Ligjor ka vërejtur dokumentacione të pakompletuara te disa prej tyre dhe ka kërkuar dokumentacione shtesë. Sapo të kompletohen, presidenti do t'i dekretojë anëtarët e rinj të KQZ-së", është thënë në përgjigjen me shkrim nga Zyra për Informim e Presidentit.

Por kandidati për anëtar të KQZ-së nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Florian Dushi, ka thënë të mërkurën për gazetën "Epoka e re" se presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është duke vepruar në kundërshtim me rolin dhe përgjegjësitë e veta kushtetuese. Sipas Dushit, arsyetimi për "moskompletimin e dosjeve të të nominuarve" nuk i justifikon vonesat në këtë proces. "Mosemërimi i anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për më tepër se një vit nga ana e presidentit, madje nganjëherë duke u fshehur pas disa aspekteve teknike, siç është rasti me, kinse, 'moskompletimin e dosjeve të të nominuarve', nuk e justifikon në asnjë mënyrë presidentin i cili në këtë rast është duke vepruar në kundërshtim flagrant me rolin dhe përgjegjësitë e tij kushtetuese", ka deklaruar Dushi, duke shtuar se atij dhe bashkëpartiakut të tij, Sami Hamiti, nuk u është kërkuar asnjë dokument shtesë nga presidenca.

Sidoqoftë, ai ka kërkuar nga presidenti Thaçi që sa më parë ta përmbushë obligimin e vet kushtetues, duke i emëruar anëtarët e KQZ-së konform formulës së dhënë kushtetuese në mënyrë që të funksionalizohet një ndër institucionet më vitale të Republikës së Kosovës. "Është me rëndësi të theksohet se diçka e këtillë në shtetin tonë është duke ndodhur për herë të parë nga një president i cili, me gjasë, nuk po mund të shkëputet dot nga prejardhja partiake-politike. Prandaj, kërkesa ime lidhur me këtë çështje është që presidenti sa më parë ta përmbushë obligimin e vet kushtetues, pra sa më parë t'i emërojë anëtarët e KQZ-së konform formulës së dhënë kushtetuese e cila tashmë është praktikuar disa herë dhe në këtë mënyrë ta funksionalizojë njërin ndër institucionet më vitale të Republikës së Kosovës", ka theksuar Dushi.

Ndërsa i nominuari nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ilir Gashi, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se shumë shpejt presidenti do ta dekretojë përbërjen e re të KQZ-së. Ai ka theksuar se KQZ-ja pa arsye nuk ka thirrur mbledhje për t'i kryer detyrat e saj të përcaktuara me ligj sepse, sipas Gashit, në një farë forme ka pasur bojkot nga një pjesë e opozitës rreth dilemave të përbërjes se KQZ-së. Sipas Gashit, KQZ-ja me gjendjen e njëjtë kushtetuese ka mbajtur zgjedhje lokale dhe parlamentare në vitin 2013/14. "Shpresoj se presidenti do t'i thërrasë të nominuarit së shpejti për t'i dekretuar të rinjtë dhe ata që vazhdojnë mandatin. KQZ-ja pa arsye nuk ka thirrur mbledhje për t'i kryer detyrat e veta të përcaktuara me ligj sepse në një farë forme ka pasur bojkot nga një pjesë e opozitës rreth dilemave të përbërjes së saj. KQZ-ja me gjendjen e njëjtë kushtetuese ka mbajtur zgjedhje lokale dhe të përgjithshme në vitin 2013/14. Kështu që, edhe sot mendoj se mund t'i kryejmë detyrat tona sepse nuk asnjë dekret nga presidenti për përfundim të mandatit meqë presidenca e ka pasur të qartë se ne kemi mandat deri në përbërjen e re për të mos lënë vakum institucional", ka deklaruar Gashi.

Jepen çmimet për shkencëtarët e vitit 2018

Prishtinë, 30 janar (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka ndarë të mërkurën çmimin "Shkencëtar i vitit" dhe "Shkencëtar i ri i vitit" për vitin 2018, çmim ky tradicional që u ndahet shkencëtarëve të dalluar në punën e tyre kërkimore shkencore gjatë vitit.

Çmimi "Shkencëtar i vitit" iu dha dr. Driton Velës nga Departamenti i Fiziologjisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Ndërsa çmimi "Shkencëtar i ri" iu dha dr. Valdet Ukës nga Dega e Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina". Me këtë rast, ministri Bytyqi uroi fituesit e çmimit dhe i përgëzoi për angazhimin në punën e tyre kërkimore shkencore, njëherësh i inkurajoi të vazhdojnë veprimtarinë shkencore.

Ministri Bytyqi ka theksuar nevojën më të madhe të angazhimit institucional në përkrahje të hulumtuesve shkencorë, ndërsa ka thënë se duhet të shfrytëzohen edhe mundësitë e përfitimeve nga fondet ndërkombëtare.

Bytyqi ka përmendur anëtarësimin në COST, po ashtu edhe programin 'Horizon 2020' si mundësi të mira për hulumtuesit shkencorë, në mënyrë që të avancohen hulumtimi dhe shkenca në Kosovë, por edhe të ndërkombëtarizohen.

Liderët e koalicionit qeverisës janë takuar të mërkurën për të biseduar për zhvillimet e fundit në vend

Qeveria vazhdon, taksa

Udhëheqësit e koalicionit qeverisës janë pajtuar të mërkurën që koalicioni qeverisës ta vazhdojë punën. Pas një takimi dyorësh, i cili është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë, është diskutuar për zhvillimet e fundit
politike dhe për taksën ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnjës. Ata janë zotuar për shtimin e hapave dhe bashkërendimin e vendimeve me partnerët strategjikë të Kosovës, ShBA-në dhe BE-në. Vlerësim i përbashkët i tyre ishte, sipas një deklarate të Zyrës së Kryeministrit, se koalicioni është stabil dhe me më përkushtim do të vazhdojë drejt arritjes së objektivave

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 30 JANAR - Liderët e koalicionit qeverisës kanë bërë me dije të mërkurën se koalicioni qeverisë do ta vazhdojë punën. Pas një takimi, i cili ka zgjatuar më shumë se dy orë, Zyra e Kryeministrit ka lëshuar një deklaratë për medie, në të cilën është thënë se koalicioni është funksional dhe stabil. Sipas kësaj deklarate, Qeveria me përkushtim do ta vazhdoj arritjen e qëllimeve në përputhje me objektivat programore qeverisëse. "Në takimin e sotëm të liderëve të partive të koalicionit qeverisës u diskutua për zhvillimet e fundit politike në vend, për funksionimin e institucioneve, për përmbushjen e agjendës qeverisëse dhe legjislative, me theks të posaçëm aprovimin e buxhetit 2019, pakon e ligjeve përcjellëse, platformën e dialogut dhe çështjen e taksës. Partnerët e koalicionit janë pajtuar që në ditët në vazhdim t'i shtojnë veprimet dhe aktivitetet drejt harmonizimit të vendimmarrjes për sa iu takon temave të sipërpërmendura", është thënë në deklaratën për medie të Zyrës së Kryeministrit.

Sipas kësaj deklarate, në takimin ku kanë marrë pjesë kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kryetari i Nismës, Fatmir Limaj dhe kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, është biseduar kryesisht për aspektet kryesore që ndërlidhen me platformën e dialogut, e cila pritet të miratohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës. "Platforma e dialogut do ta reflektojë pozicionin unik të institucioneve të vendit për arritjen e një Marrëveshjeje Gjithëpërfshirëse Ligjërisht e Obligueshme, e cila duhet të rezultojë me njohjen reciproke dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Po ashtu, liderët e koalicionit u zotuan për shtimin e hapave dhe bashkërendimin e vendimeve me partnerët strategjikë të Kosovës, ShBA-në dhe BE-në. Është vlerësim i përbashkët se koalicioni është funksional dhe stabil. Do të vazhdohet me përkushtim për arritjen e qëllimeve në përputhje me objektivat programore qeverisëse", është thënë në deklaratën e Qeverisë së Kosovës.

nuk pezullohet

Prej rritjes së presionit amerikan për heqjen e taksës, është folur për mundësinë e rrëzimit të Qeverisë. Këto dilema janë shtuar pas propozimit të kryeparlamentarit Kadri Veseli, se taksa duhet të pezullohet për 120 ditë. Kryeministri Ramush Haradinaj edhe të mërkurën ka deklaruar se nuk do ta heqë taksën pa e marrë njohjen nga Serbia. Gjatë akademisë përkujtimore në Junik, kushtuar Zahir Pajazitit, Edmond Hoxhës dhe Hakif Zejnullahut, kryeministri Haradinaj për herë të parë ka deklaruar se ndërkombëtarët kanë kërkuar që Kosova të japë tokë ose një Republika Serpska brenda territorit të vet për ta marrë njohjen nga Serbia. "Ndërkombëtarët na kanë thënë çka jepni ju që t'ju njohë Serbia. Ata vazhdimisht na kanë bërë këtë pyetje. Ne i kemi thënë se i kemi 20 mijë gra të dhunuara, 17 mijë njerëz të vrarë, persona të zhdukur, ekonominë e shkatërruar, e kështu me radhë. Unë u kam thënë do të ofronim pajtim, mirëpo ata (ndërkombëtarët) kanë thënë se nuk mjafton. Na kanë kërkuar të japim tokë. Kanë kërkuar ta japim veriun, aty ku janë minierat, pra aty ku është pasuria jonë. Ose, nëse nuk jepni tokë, jepni një 'republikë' brenda republikës suaj, pra një Zajdenicë", ka thënë Haradinaj.
Ai ka bërë me dije se është i gatshëm që në këmbim të njohjes t'ia kthejë Serbisë tregun. "Unë po i lus kolegët e mi, edhe Hashimin, Kadriun, Albinin, Isën dhe Shpendin, nëse Serbia na njeh, a bën t'ia kthejmë tregun. Tregu i Kosovës është një miliard euro në vit", ka thënë ai.
Në mënyrë indirekte Haradinaj ka komentuar edhe idenë e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, për pezullimin e taksës për 120 ditë. "Nëse ia hapim derën Serbisë për 120 ditë nuk kemi nevojë më të vendosim taksë, sepse ajo nuk e ka më vlerën e vet", është shprehur kryeministri. Sipas tij, është mirë që Kosova të jetë e sinqertë me miqtë e vet, me ShBA-në dhe Evropën, dhe t'u tregojë arsyen e marrjes së këtij vendimi për taksën.

PDK-ja kërkon që mos të dëmtohet miqësia me ShBA-në

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka shprehur shqetësimin për, siç ka thënë, mungesën e theksuar të bashkërendimit dhe bashkëveprimit institucional për çështjet e interesit shtetëror të Kosovës. "Partia Demokratike e Kosovës kërkon që të hiqet dorë nga qasja dhe protagonizmi i njëanshëm politik, i cili po e shpie vendin në krizë politike, në kohën kur sfidat me të cilat përballet shteti ynë kërkojnë unitet kombëtar. Pikëpamjet personale janë legjitime, por qëndrimi zyrtar dhe vendimmarrja për vendin duhet të jenë shtetërore, gjithmonë dhe në çdo rast", është thënë në deklaratën e PDK-së. Sipas kësaj partie, Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i shtetit dhe asnjë vendim nuk ka vlerë pa marrë miratimin e deputetëve të tij.
Partia Demokratike e Kosovës ka kërkuar që të hiqet dorë nga deklarimet për korrigjimin e kufijve. "Partia Demokratike e Kosovës kërkon që të hiqet dorë nga deklarimet e thirrjes së një konference ndërkombëtare për Kosovën. Kjo ide përmban rrezikun real të rihapjes së statusit final të Kosovës, i zgjidhur përfundimisht me shpalljen e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, si dhe rrezikun e përfshirjes së Rusisë në proces. Kosova shkon në dialog vetëm për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë, njohjen reciproke, ulësen në OKB dhe përshpejtimin e anëtarësimit në BE dhe NATO", është theksuar në deklaratën e PDK-së, duke kërkuar edhe nga forcat politike opozitare që t'i marrin përgjegjësitë shtetërore ndaj vendit. "Lidhja Demokratike e Kosovës ta ndalë përdorimin e gjuhës denigruese të zyrtarëve të saj dhe ikjen nga përgjegjësia shtetërore, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje të distancohet nga diskursi i saj antishtet dhe ta njohë shtetin e Kosovës. Pozicioni i Partisë Demokratike të Kosovës është i qartë dhe i prerë: Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe çdo vendimmarrje duhet të dalë dhe të legjitimohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në kuadër të delegacionit shtetëror dhe platformës së përbashkët. Në fund, çdo vendimmarrje e arritur në përfundim të dialogut me Serbinë duhet të legjitimohet nga vullneti i drejtpërdrejtë i popullit të Kosovës me referendum dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës", është thënë në deklaratën për medie të PDK-së.

Zahiri, Hakifi dhe Edmondi dëshmuan se shqiptarët nuk mund të mposhten në përpjekjet për liri

EPOKA E RE Qendresa RAMA

Junik, 30 janar - "Rënia e Zahirit, Hakifit dhe Edmondit, në mënyrën aq heroike, në përpjekje, duke rezistuar e luftuar, bëri kthesë në kalkulimet tona, në mënyrën se si ne e planifikonim më tutje se çfarë duhet të ndodhë, ku në këtë rrugëtim filloi edhe një seri e ngjarjeve të tjera që do të dëshmojnë se shqiptarët nuk mund t'i mposhtin në përpjekjet për liri. Duke i nderuar këta heronj, ne e vërtetojmë se e dimë rrugën tonë deri këtu dhe rrugën edhe më tutje", ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në akademinë përkujtimore në 22-vjetorin e rënies së heronjve të kombit, Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu, pasi ka bërë homazhe te shtatorja e heroit Edmond Hoxha.
Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj ka thënë se sot në vendlindjen e Edmondit po bashkohen edhe familjet e Zahirit e të Hakifit, po bashkohen të gjithë, ashtu siç ishin ata, por në Junik.
Duke folur nga Juniku, kryeministri Haradinaj ka thënë se ky vend, është vend i atdhetarëve të zotë dhe i përpjekjeve për liri. Ai ka thënë se nga ky vend në çdo etapë kanë dalë përpjekjet për liri, njerëz që i kanë ndihmuar ato procese. "Jo të gjithë kanë bërë emër që t'i njohë i gjithë kombi, por asnjëherë në asnjë etapë nuk ka munguar kontributi i Junikut. Juniku është vendi që është vënë në shërbim të lirisë e identitetit tonë kombëtar, janë njerëz të dijshëm që kanë ditur t'i lexojnë drejt situatat, që në çaste kyçe të vendosin për veprime unike, që rrallë ka ndodhur në etapa të tjera, vende të tjera shqiptare dhe etapa historike", ka thënë kryeministri Haradinaj.
Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka thënë se rënia e heronjve është sinonim i bashkimit të vlerave që ia dhanë vulën e lavdisë.
Të pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishin përfaqësues institucionalë të nivelit qendror dhe lokal, familjarë të heronjve, bashkëluftëtarë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë.
Nga një fjalë rasti para të pranishëmve mbajtën edhe përfaqësuesi i Shoqatave të Dala nga Lufta, Niman Tofaj, si dhe në emër të familjarëve të heronjve foli Floreta Zejnullahu.

Nuk ka skenarë të mirë me skenaristë të këqij

Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Dikujt po i kruhet, dikujt po i luhet: Mund edhe të mos pajtoheni me vlerësimin tim por, përfundimisht, kemi politikanë jashtëzakonisht inteligjentë, të lexuar, të besës, të fjalës, me një integritet të lartë moral, profesional, sidomos material!

Po i shohim zhvillimet e fundit rreth taksës 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja, dy shtete skajshmërisht armiqësore ndaj Kosovës. Këtë armiqësi, jo që nuk e fshehin, por krenohen me të. E keni parë Malli Sllobën (Sllobën Picimul), Ivica Daçiq, duke u krenuar me ç'njohjet që bëjnë disa shtete e se këtë e bëjnë duke u mbështetur në argumentet e Serbisë. Gjithashtu, ky picimul krenohet edhe me bllokadat që ia bën Serbia Kosovës dhe për këtë nuk më kujtohet të kenë reaguar dyshi mashtrues, Frederika Mogerini dhe Johanes Han, sikur as edhe një ambasadë e vetme në Beograd apo Prishtinë. Po të kishte Kosova politikanë që e respektojnë minimumin e krenarisë kombëtare dhe sakrificën e bërë më shumë se 100 vjet, Serbia nuk do të ishte fare e pranishme në Kosovë. Po të mos i hapnin shalët në Rambuje, duke pranuar çdo gjë që iu ishte ofruar, nuk do të ishte Marrëveshja Tekniko - Ushtarake në Kumanovë ku shqiptarët dhe Kosova u futën në sandviç midis ndërkombëtarëve dhe Serbisë dhe u shkërdhyen mirë e mirë, pa pasur aspak qasje në fatin që ia shkruan të tjerët. Disa nga këta pehlivanë hajdutë luajtën keq me gjakun e derdhur duke u shndërruar në milionerë dhe duke ua zëvendësuar armët e gjata TMK-së, gjithashtu me "armë të gjata", kazma dhe lopata! Lëshimet ishin zinxhirore, deri në ditët tona; gjatë bisedimeve të Vjenës, Pakoja e kriminelit kushtetues Marti Ahtisari, 6 pikat e Sllobodan Samarxhiqit të përkthyera në 6 pikat e Ban ki Munit, organizimi i zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë nën përkujdesje të OSBE-së, mosndjekja dhe mosndëshkimi i krimeve serbe në Kosovë, formimi, mirëmbajtja dhe forcimi i strukturave paralele të Serbisë në Kosovë, injorimi dhe mohimi i institucioneve të Kosovës në vendet ku jetonin serbët, ndarja e qytetit të Mitrovicës në dy pjesë 18 vjet pas përfundimit të luftës, vrasja e qytetarëve joserbë dhe dëbimi i dhunshëm i më shumë se 13 000 mijë shqiptarëve dhe joserbëve nga veriu i Kosovës, lirimi nga burgu i Mitrovicës të 22 të dyshuarve për krime lufte e që pastaj disa shkuan në Serbi, kurse disa iu bashkuan organizatës kriminale "Rojat e Urës" dhe grupeve të tjera kriminale, deri te vrasja e policëve të Policisë së Kosovës sikur edhe vënia e zjarrit pikave doganore në Jarinje dhe Bërrnjak, ditën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Serbët për më shumë se 18 vjet nuk paguan për rrymën e shpenzuar, kurse hajnat ndërkombëtarë dhe vendorë këto shpenzime ua faturuan shqiptarëve duke i plaçkitur për aq kohë dhe vazhdojnë t'i plaçkitin edhe sot e kësaj dite. Kosovës iu imponuan bisedimet e pabarabarta nga të cilat doli fitues vetëm Serbia dhe një grup skajshmërisht i kriminalizuar i politikanëve vendorë. Po të mos ishte një atdhetar shembullor dhe sakrifikues, i dijshëm përtej standardeve shqiptare dhe kosovare, mik i ngushtë i dy njerëzve më të fuqishëm në botë, Putinit dhe Trampit, siç është Behgjet Pacoll, Daçiqi do ta vazhdonte plojën mbi diplomacinë kosovare por, Begja, së bashku me bashkëpatriotët Dardan Gashi, Shpend Ahmeti, Enver Hoxhaj, u vënë si mur i gjallë para eskadronit pushkatues të Serbisë dhe, ende janë gjallë! Madje, të përparuar në karrierë. Po të më jepnin edhe 10 milionë euro ta bëj ranglistën se cili prej tyre është më patriot, më sakrifikues, më i dijshëm, më i ndershëm, më pakurrizorë, sigurisht se do ta humbja bastin. E kam të pamundur ta bëj ndarjen dhe renditjen. Mirëpo, fati i përcjellë të guximshmit dhe në skenë dolën dy patriotë dhe trima të jashtëzakonshëm, Enver Hoxhaj dhe Endrit Shala (me shaljanë nuk ka mahi nëse e kujtoni këngën për shtatë shaljanë sikur edhe me hoxhallarët e Therandës nëse i referohemi këngës, Enver Hoxhaj e mbrehu shpatën - taksën 100 %) që ia futën taksën 100 % për mallrat nga Serbia e Malli Sllobës dhe Srpska Krajina e Dodigut. Thuaja u bë kiameti dhe pas kësaj filluan presionet e mëdha ndaj Qeverisë së Kosovës dhe Ramush Haradinajt ta heqë këtë taksë. Më të zëshmit ishin lobistët e Serbisë në BE, Frederika Mogerini dhe Johanes Han. Vuçiqi, i dalë nga sperma politike dhe shoviniste e Sheshelit, tërë ditën rri me mindilë në dorë para të huajve duke u ankuar se serbët në Kosovë dhe aleatët e tyre si puna e disa tajkunëve kosovarë që flasin shqip, po vdesin urie dhe nga sëmundjet për shkak të mungesave të barërave. Donald Tramp, presidenti amerikan, shok i ngushtë i Behgjet Pacollit, mentorit politik dhe sidomos ekonomik i presidentit Thaçi, i dërgoi një letër Hashim Thaçit e cila, sipas meje, është shumë e keqe dhe shumë e dëmshme për Kosovën dhe shumë e mirë dhe shumë e dobishme për Serbinë. Dje e dëgjova përmes Radio Dukagjinit një pjesë të letrës apo përgjigjes që ia kishin dërguar presidentit Tramp. Nga ajo pak që e dëgjova, fitova përshtypjen, dhe jo vetëm përshtypje, por një siguri të madhe, se atë përgjigje e kishte dërguar Aleksandar Vuçiq, presidenti çetnik i Serbisë. Më vonë e dëgjova përsëri leximin e kësaj letre dhe u ndala te një fjalë që, përveç Hashim Thaçit dhe Papë Françeskut, nuk e kupton askush, fjalën celebrim. Realisht, nga aspekti i rimës disi edhe përputhet por, Hashim dhe celebrim nuk shkon nga perspektiva euroatlantike. Pastaj, pata mundësinë ta lexoj letrën në tërësi dhe 100 % jam i sigurt se nuk e ka shkruar presidenti Thaçi atë letër. Ajo letër është krejtësisht pakurrizore, me fleksibilitet deri në lëvyrje. Prandaj, duke e njohur presidentin Thaçi si personalitet me integritet të lartë njerëzor, kombëtar, moral dhe politik, ai, kurrë dhe në asnjë rrethanë nuk do ta shkruante atë letër. Mund të jetë firma e presidentit Thaçi, mirëpo nënshkrimi edhe mund të klonohet. Kurrë Hashim Thaçi nuk do ta shkruante këtë letër! Madje, po të mos përmendej në atë letër Kosova, titulli i presidentit dhe disa gjëra identifikuese, kisha menduar se kjo letër është dërguar nga ato që më parë i kanë ofruar shërbime orale dhe gjeostrategjike presidentit Tramp dhe faturat, në kesh i ka paguar avokati i Trampit. Jo, jo, Hashimi nuk lëshohet në këso lojëra ani pse e ka një kotillë politike shoqëruese dhe shërbyese të përbërë nga prostitutat politike dhe morale! Po të mos e lexoja këtë letër prostituimi, nuk do t'u besoja veshëve për faktin se dëgjimin ma kanë marrë, si trofe, paraardhësit biologjikë, politikë, kombëtarë dhe njerëzorë të disa këshilltarëve të Hashimit, Kadrisë, Ramushit dhe bartësve të pozitave të larta të tjera, në burgjet dhe llogoret e Sarajevës, Foçës, Mostarit, Zagrebit, Rijekës, Lepogllavës, Gospiqit, Stara Gradishkës, Sllavonska Pozhegës dhe qendrave të tjera "rehabilituese" ku shëroheshin dhe trajtoheshin armiqtë e Jugosllavisë dhe bashkim-vëllazërimit apo shqiptarët, si puna ime. Po deklarohem publikisht se edhe me mend nuk jam fort mirë, prandaj nuk marrë përgjegjësi për shkrimet e mia. Jam fare i papërgjegjshëm, para ligjit, robit dhe Zotit! Prandaj, kurrë nuk bëra karrierë politike, nuk më bënë deputet, ministër apo zëvendësministër e lëre më ambasador ose kryetar i ndonjë bordi. Një herë më pyetën nëse do të pranoja të bëhem shef, SHEF, i ndërrimit të trenave në Fushë-Kosovë dhe, pasi, me përulësi pranova, më kërkuan kualifikimin shkollor dhe profesional dhe kur iu tregova se statusi im shkollor është shkollë e mesme e përfunduar dhe student i përjetshëm, gati se nuk më futën nën një tren që udhëtonte për Mitrovicën e Goran Rakiqit. Nuk e ulim thanë nivelin sepse, filan komandanti ka mbaruar magjistraturën për menaxhim të biznesit, tjetri është doktor i marrëdhënieve ndërkombëtare, Shkurta, ani pse është dashnore e Llullës, e ka përfunduar fakultetin e shkathtësive orale me notën mesatare 10.23. Definitivisht, jam i pafat, e pranoj!

A të hiqet taksa a po rrëzohet kasta: Ashtu siç e kam idol Behgjet Pacollin për patriotizëm, Dardan Gashin për ndershmëri, pas vdekjes së Hajdar Shtimes, idol dhe ideal për guxim e kam Enver Hoxhajn. Sidomos kur u bë publik fakti se ai, e jo Ramush Haradinaj, ishte baba i taksës 100 % për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Me këtë krenohej, me shumë të drejtë, vetë Enveri, partia Kosova dhe krejt shqiptaria. Enveri shkoi edhe më tej, tha se kemi edhe masa të tjera ndaj Serbisë. Me Enverin krenohej edhe kryetari i partisë, zoti Veseli, presidenti Hashim Thaçi dhe krejt PDK-ja, me degë, nëndegë, arterie, kapilare, granim, burrnim, të rinj, fëmijë, faqezi dhe axhami. Madje, më kanë thënë, por nuk e kam dëgjuar me veshët e mi, se para çdo takimi të rëndësishëm të PDK-së, e sidomos Grupit Parlamentar, në vend të himnit kosovar të kompozitores së talentuar dhe të mirënjohur Tina Kajdanov, ose atij kombëtar që dëgjohej shumë rrallë, thuaja u përditësua himni i ri i PDK-së, kënga: "Enver Hoxhaj, o, e mbrehu shpatën, edhe një herë o për situatën..." Po kjo këngë mbeti në top lista derisa ambasadori amerikan në Prishtinë nuk e solli një këngë tjetër në zyrat e shokut Enver! Kjo kënga e ambasadorit amerikan nuk ishte tamam këngë argëtuese apo Odë Trimërie, por një marsh funebër për taksën 100 % të shokut Enver! Partia e shokut Enver e ka bërë gati ekipin përgatitor për varrimin e taksës 100 % e me këtë edhe varrimin politik të Ramushit. Me një fjalë, u bë puna skllotë, në mos edhe më keq! Kur shoku Enver e mbronte të drejtën e autorit për taksën 100 %, para se ta hapte gojën, është dashur ta rrudhte apo ta mbyllte prapanicën dhe, në këtë rast, po të vepronte kështu, nuk do të vinte në situatë që është sot, e ka mbyllë krejtësisht gojën ndërsa e ka hapur krejtësisht prapanicën!

Po çka nëse bie qeveria dhe shkohet në zgjedhje: Nëse taksa pezullohet për 120 ditë, nuk ka nevojë të kthehet kurrë më. Pas kësaj që po ndodh, edhe nëse në Kosovë hyjnë mallrat nga Serbia, duhet të jeni pa asnjë skrupull moral dhe ndjeshmëri njerëzore nëse i blini ato mallra. Nëse Serbia e kushtëzon vazhdimin e bisedimeve me heqjen e taksës 100 % dhe ky kushtëzim pranohet nga bashkësia ndërkombëtare atëherë Ramush Haradinaj duhet menjëherë ta heqë taksën 100 % dhe vazhdimin e bisedimeve ta kushtëzojë me ndriçimin e fatit të personave të pagjetur. Nuk besoj se bashkësia ndërkombëtare e kundërshton këtë kushtëzim aq më parë që në mesin e të zhdukurve ka, përveç shqiptarëve që janë shumicë, edhe serbë, romë, boshnjakë etj. Ose nuk duhet të ketë kushtëzime fare, ose kushtëzimet duhet të vlejnë për të dyja palët: shqiptare dhe serbe!

(Vijon)

SBAShK-u: Koeficientet janë të papranueshëm, greva vazhdon

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Këshilli Drejtues i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBAShK), në takimin e jashtëzakonshëm të së mërkurës, ka marrë vendim për vazhdimin e grevës, duke i konsideruar të papranueshëm koeficientet për sistemin e arsimit në Projektligjin për paga. "Koeficientet e aprovuar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media janë pothuajse të ngjashëm me ofertën e kryeministrit dhe, përveçse nuk kanë plotësuar kërkesat e punëtorëve arsimorë në Kosovë, këta koeficientë, përveç dallimeve të mëdha me sektorë të tjerë, kanë të meta të mëdha edhe brendapërbrenda tërë sistemit arsimor. Në veçanti, kritikë e madhe iu dha koeficientit për drejtor dhe zëvendësdrejtor për të gjitha institucionet arsimore, por edhe koeficienteve të tjerë. Duke analizuar gjithë këto, Këshilli Drejtues, së bashku me kryetarët e sindikatave komunale të arsimit parauniversitar dhe ata të universiteteve, vendosën njëzëri që t'i shpallin të papranueshëm për punonjësit e arsimit këta koeficientë dhe të vazhdohet greva edhe në ditët në vijim", është thënë në komunikatën e SBAShK-ut. Po ashtu, Këshilli Drejtues i SBAShK-ut ka kërkuar nga kryeministri Ramush Haradinaj, ministri Mahir Jagxhillar dhe ministri Shyqiri Bytyqi, që të tërhiqet Projektligji për paga në mënyrë që ky projektligj të rishikohet në një situatë të re dhe pa tensione.

Tahiri: Projektligji për paga dëmton dhe degradon sundimin e ligjit në Kosovë

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se parametrat rregullativë të vendosur në Projektligjin për paga kanë prekur dhe degraduar pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve duke tjetërsuar konceptin e pavarësisë së sistemit gjyqësor si pushtet i tretë. Ai ka shprehur mospajtime me propozimet e dhëna në këtë projektligj, të cilat, sipas Tahirit, cenojnë pavarësinë e gjyqësorit

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, të mërkurën ka reaguar ndaj ndryshimit dhe plotësimit të Projektligjit për paga që, sipas tij, rrezikon pavarësinë e sistemit gjyqësor në vend. Ai ka thënë se Republika e Kosovës është duke bërë përpjekje për të vendosur një formulë mbi sistemin e pagave dhe kjo është më se e nevojshme por, sipas Tahirit, drejtimi që kanë marrë disa elemente rregullative të parapara me Projektligjin për paga janë në shpërputhje me vlerat e një demokracie në të cilën pushtetet janë të ndara dhe të barabarta. "Jam tejet i shqetësuar me faktin se parametrat rregullativë të vendosur në këtë projektligj kanë prekur dhe degraduar pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke tjetërsuar konceptin e pavarësisë së sistemit gjyqësor si pushtet i tretë dhe i pavarur. Kam shprehur dhe shpreh mospajtimin tim të plotë me propozimet e dhëna në projektligj, të cilat cenojnë pavarësinë e gjyqësorit", është shprehur ministri Tahiri.

Ai ka thënë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë gjyqësor të pavarur, të pandikuar nga politika në asnjë mënyrë dhe pavarësia financiare është thelbësore për profesionalizimin e mëtejshëm të këtij sektori.

Po ashtu, Tahiri ka bërë me dije se do të kërkojë që të përfillet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë që pagat të rriten për stafin civil të punësuar në gjykata dhe prokurori. "Do të kërkoj edhe një herë nga komisionet e Kuvendit që të shqyrtojnë me kujdes mënyrën se si trajtojnë gjyqësorin, meqenëse kjo është jetike për funksionimin e demokracisë sonë. Pres që në ditët në vijim, deputetët të reflektojnë dhe të mundësojnë avancimin e reformave të ndërmarra në vitin e fundit, për të krijuar një ambient pune të përshtatshëm për gjykatësit dhe profesionistët e tjerë dhe për të mundësuar që ky sistem të jetë i besueshëm për qytetarët e vendit", ka theksuar ministri Tahiri.

Limaj: Marrëveshja me Serbinë duhet të sjellë paqe dhe perspektivë për dy vendet

PRISHTINË, 30 JANAR (ER) - Zëvendëskryeministri, njëherësh bashkëdrejtues i delegacionit të Kosovës për bisedime me Serbinë, Fatmir Limaj, ka pritur të mërkurën në takim drejtorin për Ballkan në Ministrinë e Jashtme të Gjermanisë, Christian Helbach, dhe ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt.

Në këtë takim është diskutuar për zhvillimet e tanishme, me theks të veçantë dialogun Kosovë - Serbi. Bashkëkryesuesi i delegacionit shtetëror e ka informuar zyrtarin gjerman për punën e këtij delegacioni si dhe platformën për dialog me Serbinë. Limaj ka thënë se kjo platformë do ta paraqesë zërin unik të Kosovës dhe do ta reflektojë vizionin dhe pozicionin zyrtar të vendit në bisedimet me Serbinë. "Ishte konkludim i përbashkët që marrëveshja gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të sjellë paqe dhe stabilitet në këtë pjesë të rajonit dhe të hapë perspektivë evropiane për të dy vendet", ka thënë Limaj, duke e falënderuar Helbachin dhe ambasadorin Heldt për ndihmën e vazhdueshme që shteti gjerman ka dhënë për Kosovën në të gjitha etapat.

Rritet numri i pasagjerëve që shfrytëzojnë trenin dhe aeroplanin

Prishtinë, 30 janar (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit" për TM4 2018, me të dhëna mbi transportin ajror, hekurudhor, rrugor dhe telekomunikimin. Sipas ASK-së, në territorin e Kosovës janë gjithsej 333 kilometra binarë hekurudhorë për transport.

Në tremujorin e katërt të vitit 2018, numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi ishte 33 000. "Ndërsa, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM4 2017), numri i udhëtarëve është rritur për 31.68 për qind. Transporti i mallrave me tren në tremujorin e katërt (TM4 2018) ishte 213 mijë tonë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (TM4 2017), ku ka rritje për 11.19 për qind", është thënë në raportin e ASK-së.

Kurse sa i përket numrit të fluturimeve në tremujorin e katërt të vitit 2018 janë realizuar 1 862 fluturime ose 13.12 për qind më shumë se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM4 2017). "Kurse, numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar aeroplanin si mjet transporti gjatë këtij tremujori ishte rreth 500 000, në raport me tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (TM4 2017), ku ka një rritje për 19.63 për qind. Në vitin 2018, në Kosovë janë të regjistruara 343 631 mjete motorike dhe jomotorike në raport me vitin 2017, ka një rritje për 2.75 për qind", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas të dhënave të prezantuara, në vitin 2018 në territorin e Kosovës ka 2 074.7 kilometra rrugë, ku në kategorinë e rrugëve autoudhë ishin 6 për qind, rrugë nacionale 31 për qind, ndërsa 63 për qind janë rrugë rajonale. "Bazuar në kërkesën e Eurostatit, duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2018 (TM2 2018), publikimi ka pësuar disa ndryshime në pjesën e telekomunikimit, duke përfshire të dhënat edhe nga operatorë të tjerë", është thënë në raportin e ASK-së.

Numri i bizneseve në Kosovë shënon rritje

Prishtinë, 30 janar (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar repertorin statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për tremujorin e katërt të vitit 2018 (TM4 2018). Sipas ASK-së, në tremujorin e katërt (TM4) janë regjistruar gjithsej 2 401 ndërmarrje, ku vërehet rritje për 8.5 për qind krahasuar me tremujorin paraprak (TM3 2018). "Ndërkaq, krahasuar TM4 2018 me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM4 2017), ka pasur rritje për 25 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara. Po ashtu, krahasuar me vitin 2017, në vitin 2018 ka pasur rritje për 6.3 për qind të ndërmarrjeve të regjistruara", është thënë në raportin e ASK-së. Sipas ASK-së, aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: tregtia me 561 ndërmarrje të regjistruara (23.4 për qind); prodhimi me 280 ndërmarrje të regjistruara (11.7 për qind); akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 252 ndërmarrje të regjistruara (10.5 për qind); ndërtimtaria me 244 ndërmarrje të regjistruara (10.2 për qind); aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 212 ndërmarrje të regjistruara (8.8 për qind); bujqësi, pylltari dhe peshkatari me 156 ndërmarrje të regjistruara (6.5 për qind); ndërsa aktivitetet e tjera marrin pjesë në shkallë më të vogël. "Në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2 318 ndërmarrje të regjistruara në këtë tremujor (96.5 për qind); me 5 deri 9 të punësuar janë 58 ndërmarrje të regjistruara (2.4 për qind); 10 deri në 19 të punësuar 19 ndërmarrje të regjistruara (0.8 për qind); 20 deri 249 të punësuar me 6 ndërmarrje të regjistruara (0.2 për qind); ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar nuk ka asnjë ndërmarrje të regjistruar gjatë këtij tremujori", thuhet në raportin e ASK-së.

Sipas këtij raporti, sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave, ashtu si në çdo tremujor, mbizotëron Komuna e Prishtinës me 766 ndërmarrje të regjistruara (31.9 për qind); Prizreni me 212 ndërmarrje të regjistruara (8.8 për qind); Ferizaj me 188 ndërmarrje të regjistruara (7.8 për qind); Peja me 124 ndërmarrje të regjistruara (5.2 për qind); Gjilani me 109 ndërmarrje të regjistruara (4.5 për qind); ndërsa komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.

Më 2 shkurt seanca për buxhetin

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që më 2 shkurt të mbahet seanca për shqyrtimin e miratimit të Projektbuxheti të Kosovës për vitin 2019. Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka thënë se kjo seancë do të ketë nëntë pika të rendit të ditës. Ndërkaq shefi i grupit parlamentar i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Sejdiu, shpreson se deri më 2 shkurt do të plotësohen kushtet e kësaj partie për votimin e buxhetit

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 JANAR - Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka marrë vendim të mërkurën që më 2 shkurt të mbahet seanca e Kuvendit të Kosovës në të cilën do të votohet projektbuxheti për këtë vit. Pas mbledhjes së kryesisë, kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se kjo seancë do të ketë nëntë pika të rendit të ditës. "Seanca ka të bëjë me buxhetin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që qytetarët, punonjësit e sektorit publik dhe të gjithë sektorët e investimeve, të funksionojnë në Republikën e Kosovës", ka deklaruar ai.

Së bashku me projektbuxhetin në seancë do të shqyrtohet për miratim edhe Projektligji për pagat. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Sejdiu, shpreson se deri më 2 shkurt do të plotësohen kushtet e kësaj partie për votimin e buxhetit. "Seanca për Projektligjin për ndarjet buxhetore mbahet më 2 shkurt. Në rend të ditës, para votës për Projektligjin për ndarjet buxhetore është Projektligji për paga dhe dy projektligje të tjera që lidhen me temën e pagave. Besoj se më 2 shkurt edhe kushtet e PSD-së do të plotësohen", ka thënë Sejdiu pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Sa i përket shkarkimit të ministrit të Bujqësisë, Nenad Rikallo, Sejdiu ka thënë se dita e shtunë nuk është larg. "Ne i kemi bërë publike kushtet. Sot është votuar për datën e mbajtjes së mbledhjes. Ka arsye që ndërlidhen edhe me kushtet. Unë po besoj se dita e shtunë nuk është larg", është shprehur Sejdiu.

Kryesia e Kuvendit kishte paralajmëruar më herët se Projektligji për buxhetin e këtij viti do të votohej më 31 janar. Kosova ka hyrë në vitin 2019 pa buxhetin e miratuar nga Kuvendi. Nga 2.3 miliardë euro sa parashihet buxheti i Kosovës për këtë vit, shpenzimet për kategorinë paga dhe mëditje është paraparë të jenë 616 milionë euro, kurse rreth 770 milionë euro të tjera do të ndahen për investime kapitale.

Hamza: Nëse buxheti s'kalon, asnjë pagesë për muajin shkurt nuk mund të bëhet

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se nëse nuk kalon buxheti, në fund të muajit shkurt nuk mund të bëhet asnjë pagesë, përveç të paguhen borxhe. Ministri Hamza beson se do të jenë numrat për votimin e buxhetit. "Në situatën hipotetike, nëse buxheti nuk aprovohet, atëherë asnjë pagesë për muajin shkurt nuk mund të ndodhë, përveç pagesave për borxhin. Mirëpo, besoj në racionalitetin dhe arsyeshmërinë e deputetëve që ta votojmë buxhetin dhe shteti të funksionojë", ka thënë Hamza para gazetarëve. Ai ka thënë se janë plotësuar kushtet ligjore që buxheti të kalojë në Kuvend. "Dëshiroj të besoj se buxheti do të kalojë. Janë kryer të gjitha proceduarat", ka deklaruar ministri Hamza.

Lekaj kërkon kontributin e qytetarëve të Pejës dhe të Istogut për autostradën e Dukagjinit

PEJË, 30 JANAR (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të mërkurën mori pjesë në dëgjimet publike me qytetarët e Pejës dhe të Istogut për autostradën e Dukagjinit. Duke i inkurajuar qytetarët që t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre për këtë projekt të rëndësisë së madhe për zhvillimin e Dukagjinit, ministri Lekaj ka thënë se ky projekt do të ndikojë dukshëm në lëvizjen e lirë të mallrave e qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik të Dukagjinit. Ai ka shtuar se Peja dhe Istogu përfitojnë shumë nga qasja në këtë autostradë, e cila i lidhë ato dhe Kosovën me korridoret paneviropiane.

Qytetarët e të dy komunave, ata të Pejës dhe të Istogut, vlerësuan lart nismën për një investim kaq të madh e të munguar deri më tani në Dukagjin, kurse me anë të një pjesëmarrjeje aktive dhanë kontributin e tyre të çmuar në këto debate për autostradën e Dukagjinit.

Sot mbahet akademike përkujtimore për Haradin Balën

Drenas, 30 janar (ER) - Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së veteranit të UÇK-së, Haradin Bala, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së degët në Drenas, sot (e enjte) organizon homazhe prej orës 10:00-11:00 në Kleçkë, ndërsa në orën 13:00 në sallën e kulturës në Drenas do të mbahet akademi përkujtimore.

Rruga kombëtare N2 Kaçanik-Hani i Elezit, e lirë për qarkullim

Kaçanik, 30 janar (ER) - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar të mërkurën se pas rrëshqitjes së dheut në rrugën kombëtare N2 Kaçanik - Hani i Elezit, rruga tanimë është tërësisht e lirë për qarkullim. "Me angazhimin e kompanisë kontraktuese nga MIT-ja për mirëmbajtje në këtë pjesë të rrugës, është bërë pastrimi i saj dhe që nga ora 09:00 e mëngjesit, qarkullimi i automjeteve në këtë pjesë i është kthyer normalitetit", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit.

Luan Hoti zgjedhet drejtor i 'Stacionit të Autobusëve'

Prishtinë, 30 janar (ER) - Luan Hoti është zgjedhur kryeshefi i ri të NPL "Stacioni i Autobusëve" në Prishtinë. Bordi i kësaj ndërmarrje dhe përfaqësuesit e Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar vlerësuan se i tërë procesi ka qenë i organizuar shumë mirë, me transparencë të plotë dhe janë përzgjedhur më të mirët.

Edhe paneli vlerësues, edhe përfaqësuesit e Ambasadës, kanë radhitur njësoj kandidatët që janë intervistuar. Si rrjedhojë, në fund të këtij procesi më së shumti pikë mori kandidati Luan Hoti.

Kryeministri pajton dy familje në Junik

Junik, 30 janar (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka qenë i pranishëm të mërkurën në ceremoninë e pajtimit të familjeve Knushi dhe Shehu në Junik. Ai ka bërë me dije se këto familje i kanë dhënë fund armiqësi në 22-vjetorin e rënies së heronjve të kombit Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha e Hakif Zejnullahu. "Shqiptari e njeh kodin e faljes si virtyt dhe kjo ishte dhe mbeti fuqia e tij. Sot isha dëshmitar i një vepre fisnike shqiptare në Junik. Në nderim të 22-vjetorit të rënies së heronjve të Kombit Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha e Hakif Zejnullahu dhe si shenjë e unitetit tonë, Bashkim Knushi i zgjati dorën e pajtimit familjes së Ahmet Shehut duke i dhënë fund armiqësisë, si një plagë jona që duhet mbyllur përfundimisht, duke ia besuar ligjit lirinë. Familjet Knushi e Shehu, qofshin faqebardhë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Përkujtohet masakra e Malishevës

Malishevë, 30 janar (ER) - Me rastin e 29-vjetorit të masakrës së Malishevës, të mërkurën janë bërë homazhe në vendin e rënies, përkatësisht në pllakën e ngritur për dy të vrarët, Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, si dhe janë bërë homazhe në varrezat e tyre në Malishevë dhe Bubavec.

Homazhe kanë bërë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i shoqëruar nga kabineti qeveritar komunal, kryesuesi i KK të Malishevës, Rrahim Morina, i shoqëruar edhe nga anëtarë të kuvendit, ish-drejtuesit e komunës në vitin 1990.

Më 30 janar të vitit 1990, një ditë pas protestës së madhe në Malishevë, forcat policore kanë shtënë mbi popullatën e Malishevës, ku janë vrarë Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, ndërsa janë plagosur dhjetëra të tjerë në Malishevë dhe në katër drejtimet, në hyrje dhe dalje të Malishevës.

Ngjarja e 30 janarit të vitit 1990 është një prej ngjarjeve që shënon edhe kthesë të madhe në institucionet e asaj kohe, pasi për herë të parë është bërë një reagim dhe kundërshtim nga ana e institucioneve lidhur me vrasjen e qytetarëve të pafajshëm nga regjimi.

Krahas reagimit nga niveli komunal, është reaguar ashpër edhe në Kuvendin e Krahinës Autonome të Kosovës, nga përfaqësuesit e Komunës së Malishevës e, që më vonë, është bërë edhe suprimimi i statutit të Komunës së Malishevës dhe fshatrat e Malishevës janë shpërndarë në katër komuna. Po ashtu, kjo ngjarje, krahas reagimit institucional, kishte bërë jehonë edhe në arenën ndërkombëtare dhe të gjitha televizionet dhe agjencitë e lajmeve në tërë botën, kishin njoftuar për këtë ngjarje dhe për reagimin e institucionit të Komunës së Malishevës.

Defaktorizimi i Kosovës shqiptare, interes vetëm i Serbisë (2)

Shpallja e Pavarësisë

Xhevat BISLIMI

Politikanët e pamend dhe injorantë, të shndërruar në inatçorë, grindavecë e lakmitarë, u bënë kërcënim për lirinë e fituar me aq mund, djersë, gjak dhe flijime! Ta linin përshtypjen se mendja u punonte vetëm për atë copë pushtet që u lëshonte UNMIK-u dhe për pasuri e lavdi! Nga politikanë e luftëtarë u kthyen në uzurpatorë e grabitqarë të pushtetit, pasurisë, lavdisë e lirisë që ishin fituar me përpjekjet e gjakun e mbarë një kombi! Politikanët e vjetër e të rinj (për të vjetrit s'ishte çudi) me zotërinjtë-pushtetarët "ndërkombëtarë" silleshin si pula të lagura, kurse me popullin e tyre si "luanë"! Nuk patën ide dhe as u shkonte mendja të bënin projekte e plane për pavarësimin dhe shkëputjen e plotë të Kosovës nga Serbia dhe as për riorganizimin dhe ristrukturimin e një shoqërie dhe të një sistemi të rrënuar nga pushtimi e lufta me tendenca shfarosëse! Çdo gjë e donin për vete dhe për familjet, farefisin e tarafet e tyre! Nuk u shkonte nëpër mend se mijëra luftëtarë kishin mbetur keq: të papunë, të pastrehë e pa shkollimin-kualifikimin e duhur! Varfëria dhe korrupsioni po rriteshin. Shëndetësia, arsimi, drejtësia, siguria nuk po përmirësoheshin! Pasuria kombëtare dhe ajo pak ekonomi që kishte shpëtuar nga shkatërrimet e Serbisë po vidheshin, po kontrabandoheshin e po kollofiteshin me ligj e pa ligj me shpikjen e quajtur: AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit) dhe me rrugë e mënyra tjera ilegale! Kosova dhe pasuritë e saj po trajtoheshin si plaçkë lufte!! Shpresa e popullit shqiptar po vritej përditë! Presioni për "bosnjëzimin" e Kosovës shqiptare dhe për lidhjen e saj me njëmijenjë fije me Serbinë po rritej!Presion i paparë për rikthimin e kolonëve serbë në Kosovë, nga njëra anë, dhe ikje në rritje e shqiptarëve nga Kosova, në anën tjetër! Për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur as që bëhej fjalë! Po iknin nga vatra dhe vendi i tyre ata që ishin kthyer duke rrezikuar jetën nëpër mina! Ndjekja, arrestimi dhe dënimi i luftëtarëve të lirisë po merrte përmasat e gjuetisë së shtrigave, ndërsa politikanët e krahut të luftës, që i ishin bashkuar sundimit të ndërkombëtarëve, deklaratë: "askush mbi ligjin" dhe "ne i besojmë drejtësisë" i kishin kthyer në refren të tyre tugitës!

Në këto kushte shpërtheu revolta e madhe popullore... Shkas u bë mbytja e tre fëmijëve në Mitrovicë, por shkaku ishte gjendja e pashpresë për Kosovën. Këtu mori kthesën e vogël Kosova. Prania ndërkombëtare dhe qendrat ndërkombëtare të vendosjes u bindën përfundimisht se populli shqiptar nuk do të pranonte kurrë të mbetej me Serbinë në cilëndo formë a në cilindo variant. Prandaj, me urgjencë nisën bisedimet në Vjenë për statusin e Kosovës. Kuptohet që ndikimi amerikan ishte vendimtar. Por, projekti për "bosnjëzimin" e Kosovës sonë kishte bërë hapa para në terren në emër të "multietnicitetit" e me qëllim të deshqiptarizimit të Kosovës! Edhe seleksionimi dhe përpunimi i njerëzve të krahut të luftës dhe "piketimi" i tyre për bisedime ishte bërë... Kuptohet më të bindurit, më të pafatit dhe më të nënshtruarit ishin në "sofrën" e bisedimeve në Vjenë. Kujdes ishte treguar edhe për krahun e kolaborimit. Edhe nga ky krah nga servilët ishin zgjedhur më servilët dhe ata që bindeshin pa kushte... Menjëherë pas takimit të parë njëri nga këta puthadorët e skajshëm deklaroi me "pompozitet" se "Serbisë ia bëmë tetë me dy"! I njëjti tha edhe se "ne do të jemi gjenerozë me Serbinë dhe kërkesat e saj"! Tjetri thoshte dhe përsëriste si papagall se "po japim të dhimbshmen për ta marrë të këndshmen", etj. Kjo ishte "platforma" e grupit mjeran negociator, kjo ishte filozofia e kjo ishte logjika e negocimit me Serbinë! Ky grup mjaftohej me emrin "pavarësi', sikur të ishin të gjithë pjellë e LDK-së, që edhe në kohën e pushtimit dhe të luftës ushqente e përhapte iluzione se Kosova ishte shtet i pavarur!Me këtë ekip negociatorësh askush nuk priste rezultate tjera: një Kosovë e pavarur, por e "bosnjëzuar" territorialisht, me një kushtetutë e sistem politik të dyzuar e të kushtëzuar nga pakica serbe (5%!) - Serbia, me një Mitrovicë të ndarë në dy komuna (!), me një Veri të kontrolluar nga Serbia, me një sovranitet të dyfishtë, etj.. Për ironi Kosovës edhe flamuri shtetëror iu imponua me ngjyrat e Bosnjës! Me këto "zgjidhje" e kushte të rënda Kosova shqiptare u shpallë më 17 shkurt 2008, me shumë vite vonesë, "shtet i pavarur, demokratik e sovran"!

Republika e Kosovës dhe pozita e saj ndërkombëtare

Plani i Ahtisarit për Kosovën, i pranuar krahëhapur nga klasa politike e Prishtinës, nuk u pranua, siç edhe pritej, nga Serbia. Ky plan nuk kaloi as në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Ky dokument, që rekomandonte super të drejta për pakicën serbe dhe për trashëgimin kulturore e historike "serbe" nuk u bë dokument ndërkombëtar. Për pasojë, ky dokument, Plani i Ahtisarit, nuk e obligonte Kosovën ta zbatonte atë, sidomos në pikat ku dëmtohej rëndë substanca e Pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës... Lëshimet e mëdha që kishte bërë grupi negociator i Kosovës ia kishin rritur oreksin Serbisë, e cila mbështetej hapur nga Rusia, edhe nga Kina. UNMIK-u i dalur boje u reduktua në një prani simbolike. Një pjesë e mirëe tij u transformua në EULEX, që ishte misioni dhe dështimi më i madh i Bashkimit Evropian! Në intervistën e datës 14 qershor 2018 për Radion Dojçe Vele, Andrea Lorenzo Capussela, që ishte shef i kontrollit ndërkombëtar në Kosovë, ndërmjet tjerash deklaronte: "Po t'i shohësh ato për vitet para se të shkonte EULEX-i në Kosovë dhe më pas, atëherë sheh se shteti i së drejtës ka ngecur në vend, efektiviteti nuk rritet dhe kontrolli i korrupsionit është keqësuar. Ndërkohë që për të njëjtat periudha në shtete të tjera të Ballkanit shteti i së drejtës është përmirësuar pak po ashtu si edhe kontrolli mbi korrupsionin. Një paradoks, sepse BE-ja harxhoi 1,5 miliard dollarë për EULEX-in, misionin më të madh civil të organizuar ndonjëherë nga BE".

Po provohej (eksperimentohej) në Kosovë! Në fakt, EULEX-i ishte vazhdimësi e UNMIK-ut. Aty ku e la projektin UNMIK-u do të duhej, "me energji e forca të reja", ta vazhdonte misioni i BE-së! U vendosë edhe mbikëqyrja ndërkombëtare për "pavarësinë me kusht të Kosovës"! Vetëm aktorët e bisedimeve në Vjenë (grupi negociator) nuk ndryshoi pozitat! Përveç Ibrahim Rugovës, që kishte vdekur pa u shpallur pavarësia e Kosovës, të tjerët qëndruan të palëkundur, me gjithë dështimet e tyre, në krye të politikës së Kosovës, tash shtetit të Kosovës! Madje, paraqiteshin e silleshin edhe më të fuqishëm e vetëbesues! Tamam si etër (baballarë) të pavarësisë e të shtetit!

Për njerëzit që kuptonin diçka nga jeta e nga politika ishte e qartë se ky grupim politikanësh (kolaboratorë e "patriotë" të djeshëm) do ta hanin edhe pavarësinë e lirinë e kushtëzuar... Kurse, ata që besonin verbërisht në "udhëheqësit" e tyre besonin se pavarësia dhe sovraniteti do të bëheshin të plota! Ata besonin se edhe komunat dhe zonat e mbrojtura "serbe" do të zhbëheshin!... Racionalja dhe iracionalja po haheshin e po konfrontoheshin herë me zë e herë nën zë! Pjesë aktive dhe e zellshme e gjithë politikave dhe projekteve antishqiptare për "bosnjëzimin" e Kosovës ishin bërë shumica e medieve të shkruara dhe elektronike në Kosovë e që financoheshin, sponsorizoheshin e merreshin në mbrojtje nga prania ndërkombëtare dhe nga qarqe e qendra tjera jashtë Kosovës!...

Në disfavor të një Kosove shqiptare dhe plotësisht të pavarur nga Serbia ishte edhe gjendja kaotike në shtetin tonë AMË, në Republikën e Shqipërisë! Me një klasë politike kozmopolite, të korruptuar, të shitur e të kriminalizuar sa s'bën më, shteti shqiptar edhe pas një çerek shekulli nuk po e merrte veten! Ekonomia e rrënuar, përçarja politike (ndërpartiake), ndërkrahinore e ndërfetare, e financuar, e sponsorizuar dhe e stimuluar nga qeveri, qarqe e shërbime të huaja, po lulëzonte si rrallëherë! "Në këtë tranzicion, shkruante në komentin e saj gazeta elektronike, "Sot News", e datës 25.12.2013, çfarë pamë dhe çfarë realizuam? Pamë se si politika me grykësi të pangopur u turr për pushtet e për pasuri dhe me të famshmen shpërndarje e privatizime të pasurive vodhi, grabiti dhe abuzoi me to dhe me gjakun, mundin dhe djersën e popullit që i kishte krijuar ato; nën maskën e lirisë morën revanshin liritë negative dhe egoizmi negativ i uzurpimeve, kërcënimeve, dhunës e krimit, të trafikimit të qenieve njerëzore, të drogës, bixhozit, të përgjegjshmërisë dhe pandëshkueshmërisë dhe të ligjërimit të çdo lloj mjeti për pasurim të shpejtë. Ligji dhe drejtësia u prangosën në letër dhe ligjin e bëri e paligjshmja, e palejuara dhe drejtësinë e bëri padrejtësia, politika, korrupsioni dhe paraja".

Kundërshtarët dhe armiqtë e kombit shqiptar e kuptonin më mirë se shqiptarët dhe miqtë e tyre se defaktorizimi i Kosovës dhe dobësimi i pozitës së saj bëhej më së miri duke goditur në Tiranë... Ashtu edhe bënë. Që nga viti 1989 nuk e lanë popullin shqiptar në Republikën e Shqipërisë të shikonte një ditë të bardhë! Edhe atje, në Tiranë, në sinkron me Prishtinën, një pjesë e medieve po bënin me përpikëri dhe "profesionalizëm" punën e kundërshtarëve dhe të armiqve të kombit tonë e të çështjes shqiptare!

Në Kosovë që nga viti 1981 (sidomos), kurse në Tiranë që nga viti 1990, krah i fortë i forcave reaksionare dhe antishqiptare u bë edhe kleri fetar (pjesa dërrmuese) që financohej e po financohet e drejtohet edhe sot nga qendra të huaja kryesisht antishqiptare. Një shërbim të veçantë kësaj gjendjeje dhe këtij projekti antishqiptar po i bënte edhe shtresa e të burgosurve politikë dhe luftëtarëve të lirisë me heshtjen ose "pajtimin" në heshtje! Kjo kategori shoqërore e kombëtare, elita e saj, nuk pati guximin politik e intelektual dhe shpirtin e kundërshtimit, aq të domosdoshëm, në partitë ku bënte pjesë, në Kuvend dhe institucione tjera politike e shtetërore!!... Projekti për "bosnjëzimin" e Kosovës shqiptare, me ndonjë përjashtim, nuk u kundërshtua as nga inteligjencia! Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, e themeluar nga Jugoserbia (LKJ-ja) dhe e "përshtatur" me kushtet dhe rrethanat e reja nuk doli asnjëherë nga korniza partiake e LDK-së! Se në ç'gjendje është Akademia tregon edhe raporti i tetorit të vitit 2018, që organizata "Integra" ka prezantuar para Komisionit Parlamentar për Arsim, pas hulumtimit të bërë në Akademinë e Shkencave... Sipas Kushtrim Koliqit, nga "Integra", "ASHAK-u është në gjumë dhe nuk është llogaridhënës... të gjeturat në këtë hulumtim janë brengosëse dhe neveritëse... kjo akademi ka qenë më produktive në kohën e Millosheviqit se tash. Kur një institucion si Akademia e Shkencave është në këtë gjendje çka presim ne prej institucioneve të tjera", thotë Koliqi. Kurse, autori i këtij hulumtimi, Shkëlzen Gashi, ka thënë se "Akademia nuk ka asnjë projekt të rëndësishëm për vendin. Shumica e librave të botuara nga Akademia janë vetëm ribotime dhe shumica prej tyre vetëm në gjuhën shqipe". Pa koment!

Krijimi i komunave "serbe" në Kosovën shqiptare

Puna e parë, me përparësi e urgjencë, e institucioneve të shtetit të sapo shpallur të Kosovës, që kontrolloheshin qind për qind nga ata që negociuan (pranuan) "bosnjëzimin" e Kosovës, ishte krijimi i komunave "serbe"! E nisën me pesë e i bënë dhjetë! Ka shenja se mund të bëhet edhe ndonjë komunë nga këta që po ia marrin frymën Kosovës shqiptare! Komuna e parë "serbe" u krijua aty ku nuk kishte asnjë problem, në zemër të komunës së Vitisë me miratimin dhe nënshkrimin e një kryetari të mjerë, që ishte dorëzuar para presionit dhe shantazhit të "udhëheqësve" të tij partiakë! Zbatimi i Planit të Ahtisarit po niste në Viti e jo në veri, ku kishte probleme të mëdha në vendosjen e sigurisë, rendit, rregullit, qeverisjes dhe ligjshmërisë e kushtetutshmërisë! Me këmbëngulje e fanatizëm të paparë po zbatohej plani i Ahtisarit që nuk ishte pranuar nga Serbia! Dhe atë, po zbatohej vetëm në territorin që kontrollohej nga qeveria e Kosovës, por jo në Veri! Naivitet, padituri apo politikanë të korruptuar, të shitur e të shantazhuar?! Krijimi i këtyre komunave "serbe" krijoi avantazhe të mëdha për Serbinë, e cila sa vinte e shtonte fushatën dhe presionin e saj diplomatik, ekonomik, politik e me rrugë tjera kundër Kosovës! Lëshimet e pa fund të Kosovës po e trimëronin Serbinë. Njohjet e Kosovës nga shtetet tjera në njëfarë mënyre ndaluan pas njohjeve të para "euforike"! Shtetësia e Kosovës po sabotohej edhe nga brenda! Në krye të Kosovës i erdhi radha të "zgjidhej" kryetar (president) njeriu pro serb e pro rus, B. Pacolli! Ky njeri edhe sot mban postin më të rëndësishëm pas kryeministrit, postin e ministrit të jashtëm! Si ky, por më pak të njohur, janë me shumicë në partitë politike, në institucionet shtetërore, në medie, në arsim, drejtësi, polici, e kudo! Në Kosovë as pas pavarësisë nuk pati drejtësi tranzicionale... Salto mortale!

(Vijon)

Intervistë me veprimtarin e çështjes kombëtare, autorin e librit monografik "Goli Otoku, histori e trishtë e një krimi shtetëror

Në Goli Otok, dënime më të

Unë nuk kam qenë në burgun e Goli Otokut dhe angazhimi im për të shkruar për këtë burg e llogore nuk ka të bëjë asgjë me kujtimet e përjetimet e mia, por ka të bëjë me një përpjekje për të ndriçuar anët e errëta të shtetit jugosllav dhe të sistemit të tij tipik totalitar dhe diktatorial për një periudhë shumë të gjatë kohore. Gjatë kësaj periudhe të diktaturës jugosllave shteti ka bërë një sërë krimesh shtetërore ndaj qytetarëve të vet, një sërë krimesh mbi bazën ideologjike dhe një sërë krimesh mbi bazën etnike, krime këto që kanë mbetur të heshtura, mjeshtërisht të kamufluara para syve të botës, duke u shitur si shtet socialist me fytyrë humane

Intervistoi:
Sadik ZEQIRI

"EPOKA E RE": *Ç'dënime u jepeshin atyre që dërgoheshin për vuajtje të dënimit në Goli Otok?*

BRAHA: Dënimet për të burgosurit politikë të Goli Otokut kanë qenë tepër të rënda, që me formën, mjetet dhe metodat e përdorura shkojnë paralel, ndërsa në disa segmente edhe ua kalojnë, dënimeve në kampet e përqendrimit të nazistëve, apo në ato të gullagëve sovjetikë. Është e qartë se kampet e këtyre vendeve u kanë shërbyer si modele jugosllavëve. Përveç dënimeve të gjata kohore, atyre gjatë vuajtjes së dënimit u mohohej çdo lloj e drejte. S'kishin të drejtë të ankoheshin për burgosjen pa gjyq e pa gjykim, as për punën e rëndë, as për torturat që ushtroheshin çdo ditë, as për mangësi ushqimi, as për etjen e vazhdueshme, kur uji kufizohej me dy-tri gota në ditë. Të burgosurit shpesh ndëshkoheshin edhe me ndëshkime të tjera, me punë të rëndë shtesë, me shkurtim të gjumit, me shkurtim të sasisë së bukës, që edhe ashtu ishte vetëm 150-200 gramë në ditë, me dënim me qëndrim mbi kibëll, që është një nevojtore portative në barakë për përdorim natën nga të burgosurit, me qëndrim në diell tërë ditën etj. Dënime të shpeshta bëheshin kur të burgosurin, ose disa prej tyre, i detyronin të kalonin nëpër "shpalir", ndërsa të burgosurit e tjerë, që e përbënin "shpalirin" me dy rreshta, e kishin për detyrë që t'i godisnin sa më shumë dhe pa mëshirë shokun e tyre që kalonte në mesin e dy rreshtave, që mund të ishte i gjatë disa qindra metra. Ata që nuk e godisnin shokun i futnin në "shpalir" për t'u goditur nga të tjerët. Secili nga të burgosurit duhej të kalonte nëpër hetimin special që bëhej nga të burgosurit në dhomë, që dirigjoheshin nga udbashët aktivë. Këtë lloj të dënimit nga shokët, që ata të të rrahin deri në alivanosje, dhe hetim prej tyre deri në çmenduri, nuk e kishin në praktikën e vet as nazistët e as sovjetikët. Dhe të gjitha këto mynxyra, kini parasysh, nuk ishin për një ditë, por ishin të përditshme, aq sa edhe ushqimin detyroheshin ta hanin në këmbë dhe dy-tre veta me një lugë.

Të burgosurit thyenin gurë me gurë

"EPOKA E RE": *Ç'punë bënin të burgosurit dhe, sa kishin të drejta?*

BRAHA: Puna e parë dhe kryesore, që shërbeu edhe si torturë, ishte thyerja dhe bartja e gurëve. Fare në fillim të hapjes së llogores ka qenë thyerja e gurëve me gurë, ashtu gjithë ditën, në pikë të diellit. Pastaj janë sjellë kazma, qyskia, çekanë të rëndë dhe bartja e gurëve është bërë nga një vend në tjetrin. Gurët janë bartur në dy mënyra: në krahë dhe në lese prej dërrase. Leset mbusheshin me gurë prej rreth 100 kilogramësh dhe i bartnin dy të burgosur, ndërsa kujdestari i shtynte të shpejtonin, thuaja në vrap. Nga puna e tillë e rëndë e tërëditshme, të burgosurit rraskapiteshin, sa shpesh binin e plandoheshin për toke. Shumë prej tyre kanë përfunduar jetën nën peshën e gurëve, gjë të cilën e dëshmojnë edhe raportet e dorëzuara nga personat e autorizuar zyrtarë në instancat më të larta. Më vonë, nga puna e kotë, u organizuan punëtori për përpunimin e mermerit, prerjen e blloqeve, thyerjen e gurëve me makineri të mëdha dhe të gjitha me përfitime të mëdha sepse prodhimet bëheshin për eksport. Më vonë kanë sjellë makineri për përpunimin e drurit dhe pastaj u ngre një repart i përpunimit të metaleve dhe të riparimit të anijeve të vogla etj. Kështu u krijua një bazë industriale që fuqinë punëtore e paguante me ushqimin e ditës, ndërsa fitimet kolosale i shkonin në arkë UDB-së qendrore, pa u derdhur në buxhetin e shtetit, që këto mjete i shfrytëzonte për projektet e veta të errëta. Të burgosurit në Goli Otok nuk kanë pasur kurrfarë të drejtash. Ata janë trajtuar si numra dhe e tërë aparatura shtetërore jugosllave ka qenë në funksion të thyerjes së tyre, të familjeve të tyre dhe rrethin më të gjerë, duke i nëpërkëmbur dhe përbuzur si njerëz.

"EPOKA E RE": *Çfarë ju kujton "Gropa e Petrit"?*

BRAHA: Gropa e Petrit është një histori e veçantë. Ajo është krijuar në një gropë të braktisur nga investitorët italianë prej shumë vitesh më parë, kur ky bregdet ishte nën administrimin italian, pasi kanë konstatuar se kualiteti i boksitit ishte i dobët dhe nuk mund të sillte përfitime financiare. Me hapjen e llogores të Goli Otokut për izolimin dhe ndëshkimin e kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë, kjo gropë u shfrytëzua për izolimin dhe ndëshkimin e atyre personave që quheshin të pathyeshëm, ose të parevidueshëm. Kjo gropë, që kishte thellësi prej tetë metrash dhe diametër prej 20 metrash, kishte dhe murin përreth në lartësi prej tri metrash, ishte shumë e përshtatshme për këtë qëllim. Në të u vendos me grupin e parë edhe Petar Komneniq, kryetar i Kuvendit të Malit të Zi, andaj në zhargonin e të burgosurve është mbiquajtur "Gropa e Petrit". Brenda saj janë vendosur 130 persona në një barakë dhe ata ishin plotësisht të izoluar prej të tjerëve dhe me trajtim tej mase të egër. Ndër këta është një shqiptar, Qamil Brovina. Të jesh me vite në këtë gropë, ishte një përplasje e jetës për shkëmbi.

Burgu i fashizmit ishte kopsht; burgu i nazizmit ishte lulishte; burgu i komunizmit pansllavist ishte ferr!

"EPOKA E RE": *Në librin tuaj kemi parë dhjetëra dokumente, dhjetëra faksimile, edhe disa lista të të burgosurve politikë shqiptarë në Goli Otok që keni marrë nga Arkivi i Kroacisë, pas nxjerrjes së listës së UDB-së në periudhën e viteve 1949-1961. Gjenden aty 468 shqiptarë, me emër dhe mbiemër, të burgosur në Goli Otok, të moshave të shtyra e të reja. Çfarë ju kanë rrëfyer ata për ditët e trishta të përjetuara në atë burg?*

BRAHA: Secili rrëfim i atyre që kanë kaluar nëpër torturat dhe →

jugosllav", Meriman Braha (2)

rënda se në kampet naziste

mundimet e Goli Otokut është rrëqethës, sepse në kushtet e krijuara enkas për shpërfytyrim të njeriut, të nëpërkëmbjes së dinjitetit njerëzor, për shkatërrimin fizik e psikik të tij, objektivisht ka qenë shumë e vështirë t'u qëndrosh. Vetëm një qëllim fisnik dhe i lartë, bën, që në kohën e dërrmimit tënd fizik, të jesh superior moralisht mbi shkaktuesin e dhembjeve tua. Kjo gjithnjë i ka bërë hetuesit ta ndjenin epërsinë e forcës morale ndaj asaj fizike. Të gjithë shqiptarët që kanë qenë në Goli Otok, por edhe në burgjet e tjera, lidhen me veprimtarinë irredentiste, pavarësisht nga bindjet ideologjike, që në finale kishte gjithnjë qëllimin e shkëputjes së Kosovës nga Jugosllavia dhe të bashkimit të saj me Shqipërinë, qoftë me të drejtën e vetëvendosjes, qoftë me luftë të armatosur. Profesori i nderuar, Sami Peja, që ka qenë pjesëmarrës i LANÇ-së, ka qenë i dënuar me 13 vjet dhe ka vuajtur në Goli Otok. Në pyetjen e profesorit Skender Riza, se cili është dallimi ndërmjet burgjeve të Italisë fashiste, të nazistëve gjermanë dhe të komunistëve jugosllavë, ai përgjigjet kështu: "Burgu i fashizmit ishte kopsht; burgu i nazizmit ishte lulishte; burgu i komunizmit pansllavist ishte ferr! Në Goli Otok shtatë herë më kanë sjellë në prag të vdekjes e shtatë herë më kanë ngjallur". Vladimir Bobinac, një kroat i dënuar, për Goli Otokun thotë: "Në llogoret e kampet në Gjermani, në Siberi, në Kroaci... mbytej trupi, kurse në kampin e Goli Otokut mbytej njeriu brenda njeriut". Ja, pra, si e përjetonin Goli Otokun ata që kanë pasur fatin e keq të gjendeshin atje në ato kohë tepër të rënda.

Lista e të burgosurve politikë shqiptarë në Goli Otok është përpiluar duke i nxjerrë nga Lista e madhe, duke i ndarë ata edhe sipas komunave, edhe sipas llojit të dënimeve, duke i përfshirë të gjithë të burgosurit shqiptarë nga trevat e tyre jetësore, nga Kosova, Maqedonia dhe nga Mali i Zi.

"EPOKA E RE": *Edhe sa dosje ende s'janë bërë publike për të burgosurit në Goli Otok?*

BRAHA: Askush s'e di saktë se sa dosje janë për të gjithë ata që kanë kaluar në kampin e Goli Otokut. Ka të dhëna se nëpër këtë ishull kanë kaluar 32 000 persona, këtë e thotë Ante Rashtegorci, zëvendësdrejtor shumëvjeçar i Goli Otokut, që nga themelimi i tij. Ka të tjerë që thonë se janë mbi 60 000 vetëm për periudhën 1949-1961. Ka shumë të tjerë edhe nga radhët e shqiptarëve, që kanë vuajtur dënimet atje deri në vitin 1988, kur ky kamp, llogore e burg, përfundimisht mbyllet.

Doktori: Do t'i lëmë morrat që t'ju hanë

"EPOKA E RE": *Sa të burgosur janë vrarë në Goli Otok dhe, sa prej tyre shqiptarë?*

BRAHA: Sipas Listës së ruajtur në Arkivin e Kroacisë, kanë vdekur ose janë vrarë gjithsej 413 persona, por janë evidentuar edhe 56 persona që nuk figurojnë në këtë listë. Sipas rubrikës së arsyes së vdekjes, del se numri më i madh i të vdekurve është nga tifoja. Por, edhe kjo është vrasje, sepse nuk është bërë asnjë përpjekje për ta parandaluar epideminë e tifos, bile një doktor zyrtar i thotë një kolegu të vet të dënuar: "Do t'i lëmë morrat që t'ju hanë". Kaq ishte humaniteti i tij dhe i atyre që udhëhiqnin këtë kamp.

"EPOKA E RE": *I kemi lexuar kujtimet dhe dëshmitë e të burgosurve në ishullin e Goli Otokut që keni përfshirë në libër. Na kanë tronditur rrëfimet e tyre në atë "muze njerëzish" që mijëra mbijetojnë e qindra vdesin. Po, sa mund të themi se janë të shëndoshë të mbijetuarit?!*

BRAHA: Personat që kanë vuajtur dënimet në Goli Otok, sidomos ata të periudhës në trajtim, kanë qenë të gjithë me sëmundje të ndryshme. Të gjithë kanë qenë të traumatizuar, qoftë me pasoja fizike, qoftë me ato psikike. Në ato rrethana të rënda mendja errësohet dhe shpesh edhe vetëvrasja ishte e vetmja zgjidhje. Askush që rrëfen për ato kohë traumatike nuk mund të kalojë pa u ripërjetuar trauma, andaj shumë prej përjetuesve të tyre kanë folur pak, ose aspak. Nëse do të përshkruhej vetëm një ditë e tillë, do të shkruhej një roman, siç ka bërë Solzhenjicini në romanin "Një ditë e Ivan Denisoviqit", që ka hapur një dritare për botën për ta njohur realitetin e hidhur dhe plot vuajtje në Gullagët e Bashkimit Sovjetik, ku kalbeshin e veniteshin miliona njerëz nga krimi i organizuar shtetëror. Asgjë më pak dramatike nuk do të ishte përshkrimi i një dite në ishullin kamp të Goli Otokut. Disa prej shkrimtarëve sllavë e kanë trajtuar temën e Goli Otokut, që deri vonë ka qenë temë tabu, sepse me të godisnin drejtpërdrejt në sistemin diktatorial të vendit, që binte ndesh me pasqyrën e rrejshme të Jugosllavisë në botë.

Të dhënat për të burgosurit në Goli Otok janë në Beograd

"EPOKA E RE": *Asnjëra prej historiografive të shteteve të formuara pas shkatërrimit të Jugosllavisë nuk ka bërë sa duhet për hapjen e dosjeve për të burgosurit në Goli Otok. Pse kjo "varrosje" e fakteve?*

BRAHA: Goli Otoku ka qenë nën juridiksionin e UDB-së federative të Jugosllavisë, rrjedhimisht të gjitha të dhënat, dëshmitë dhe kombinimet e mundshme janë atje, në Beograd, në Serbi. Besoj se e vërteta e plotë do të shtyhet për kohë të tjera, ndoshta do të presë ndryshimet e mëdha në Serbi, nëse ndonjëherë bëhen, sepse ajo është, siç ka qenë, antidemokratike, thellësisht e tillë, me politika afatgjatë gjenocidale ndaj fqinjëve të saj, veçanërisht ndaj shqiptarëve. Një lloj indiference në këto vende vjen edhe prej faktit se Goli Otoku ishte burg, llogore e komunistëve kundër komunistëve, që kishte si bazë ndëshkuese ideologjinë komuniste projugosllave ndaj asaj prosovjetike. Nëse kjo mund të thuhet për serbët, malazezët, kroatët etj., kjo nuk vlente në asnjë rast për shqiptarët, të cilët në përgjithësi ishin kundër Jugosllavisë dhe pro Shqipërisë, e cila nga ky konflikt në familjen socialiste doli nga tutela jugosllave, e cila ishte gati për ta gllabëruar, duke lozur me kartën e Kosovës, që do t'i bashkohej asaj, nëse Shqipëria i bashkohet Jugosllavisë. Animi kah Bashkimi Sovjetik, Shqipërisë i hapte dy mundësi, daljen nga sfera e Jugosllavisë dhe, ndoshta, përfitim nga ndërhyrja eventuale ushtarake ruse në Jugosllavi, me bashkëngjitjen e Kosovës, si një lloj premtimi i dhënë.

"EPOKA E RE": *Çfarë i mungon librit tuaj? Pra, në rast të ribotimit, çfarë do të plotësonit në të?*

BRAHA: Pikërisht kjo i mungon, mundësia për të pasur në dorë materialet nga Arkivi i Serbisë, sepse aty janë mbyllur të gjitha mashtrimet, falsifikimet dhe planet e Serbisë, së paku për dyqind vjetët e fundit. Heqja e kësaj velloje do ta nxirrte Serbinë krejtësisht cullak me të gjithë shëmtinë e saj të jashtme e të brendshme. Po ashtu, besoj se i mungon edhe pjesa e dytë, që do ta kapte periudhën pas vitit 1961 deri në mbyllje, sepse ashtu do të kishim një tërësi përmbajtjesore. Këtë plani kam dhe shpresoj ta përmbush.

Krimet e përmasave të tilla, si në Goli Otok, nuk vjetrohen

"EPOKA E RE": Çfarë do të thoshit në fund?

BRAHA: Jugosllavia si shtet artificial dhe i ringritur në përfundim të Luftës së Dytë Botërore ka bërë një sërë krimesh gjenocidale, të cilat kanë mbetur të pandëshkuara nga Bashkësia Ndërkombëtare për shkak të konjukturave globale politike dhe të ndarjes së sferave të interesit. Si shtet, Jugosllavia ka kryer shumë krime mbi qytetarët e vet dhe për to s'ka dhënë asnjë përgjegjësi. Le t'i shohim disa prej tyre.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ka pushkatuar, pa procedurë gjyqësore, dhjetëra mijëra ushtarë të armikut të zënë robër. Mbetjet e tyre po zbulohen kohën e fundit në varrezat masive në Slloveni, Kroaci dhe në Serbi;

Menjëherë pas LDB-së janë pushkatuar pa gjyq rreth 50 000 gjermanë të Vojvodinës për shkak të përkatësisë etnike të tyre;

Janë dëbuar dhunshëm rreth 800 000 mijë gjermanë nga shtëpitë e veta në Vojvodinë duke ua konfiskuar pasurinë e tyre të paluajtshme;

Janë pushkatuar pa gjyq disa dhjetëra mija hungarezë për shkak të etnisë së tyre dhe disa dhjetëra mija janë shpërngulur dhunshëm në Hungari;

Janë shpërngulur dhunshëm mbi 100 000 italianë dhe janë pushkatuar pa gjyq 5 000 prej tyre;

Janë vrarë në Tivar disa mijëra shqiptarë të Kosovës;

Janë shpërngulur dhunshëm 350 000 shqiptarë në Turqi, duke ua ndërruar kombësinë arbitrarisht në turq.

Për krimet e bëra me forcën e shtetit të Jugosllavisë shprehet në mënyrë të qartë Aleksandër Rankoviqi, nënkryetar i shtetit, në Kuvendin Federativ, më 1 shkurt 1951, kur deklaron: "Nëpër burgjet dhe kampet tona, prej vitit 1945 deri në vitin 1951, kanë kaluar 3 777 776 persona dhe kemi likuiduar 586 000 armiq të popullit", që është një e katërta e popullatës, ndërsa të vrarë pa gjyq në çdo milion janë vrarë 41 875 qytetarë. Ky është shteti totalitar i Republikës Socialiste federative e Jugosllavisë.

Kjo është fytyra e vërtetë e shtetit socialist jugosllav me fytyrë humane, që vetëm humane s'mund të ishte; përveç në vitet e '70, që shumë shpejt pasohen nga vitet e diktaturës, terrorit dhe gjenocidit. Goli Otoku ishte dhe mbetet një nga historitë e trishta të krimeve shtetërore jugosllave, që ka mbetur gjithanshëm e pandëshkuar. Krimet e përmasave të tilla nuk vjetrohen. Ato janë krime kundër njerëzimit. Trashëgimtare e Jugosllavisë, në masën më të madhe i takon Serbisë, rrjedhimisht edhe detyrimet dhe përgjegjësitë.

(Fund)



E rrallë

Telefonon policinë për ta ndihmuar me detyrat e matematikës



Një telefonatë e pazakontë ka ndodhur në një stacion policie në Lafayette, Indiana. Një djalë ka telefonuar policinë për ta ndihmuar me detyrat e matematikës. Antonia Bundy, e cila punon për Departamentin e Policisë Lafayette, iu përgjigj telefonatës nga djali, i cili i tha asaj se kishte pasur "një ditë të vërtetë të keqe" dhe kishte shumë detyra shtëpie për të bërë. Në audion e regjistruar nga policia, Bundy fillon me qetësi të punojë me djalin.

FOTO E DITES

Një anije peshkimi shihet duke lundruar në lumin Mekong në Penhin. /AFP/

E jashtëzakonshme

Fotografia që bëri lëmsh gjithë rrjetin

Nëse e vështroni me detaje, arrini të kuptoni se është një qen i vërtetë. Kafsha shtëpiake i përket Sandra Pineda nga Filipinet, e cila u habit nga reagimi që patën njerëzit pasi publikoi fotografinë me qenin e saj. 22-vjeçarja bleu qenushin me ngjyrë të zezë Piper kur ishte vetëm dy muajsh. Piper i përket racës Xoloitzcuintle ose qenve meksikanë pa qime.

Sandra ka treguar se shumë njerëz e ngatërronin qenin me një statujë për shkak të paraqitjes unike dhe faktit që nuk ka qime.

BARSOLETA E DITËS

Fqinja rrah një fëmijë të vogël. Nëna e tij, shumë e nevrikosur, shkon për t'i kërkuar shpjegime:
- A mund ta di pse e ke rrahur djalin tim?
- Se më tha trashaluqe.
- Dhe çfarë mendoni ju zonjë, se duke e rrahur djalin tim do të dobësoheni?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Po bëheni gati të ndërmerrni një hap të rëndësishëm, po më parë doni të konsultoheni me ata që ju japin gjithmonë këshilla të vlefshme.

DEMI
Arsyeja dhe logjika nuk ju lë të merrni asnjë hap të guximshëm dhe të rrezikshëm në të njëjtën kohë. Keni nevojë për adrenalinë.

BINJAKËT
Po shijoni shumë atë çka ju ofron dita pa kërkuar asgjë më tepër. Lumturia bëhet nga çastet e vogla.

GAFORRJA
Nëse do të ndërroni qëndrim lidhur me një çështje familjare këtë do ta bëni për një arsye shumë të fortë.

LUANI
Loja që po luani me një person të caktuar do të rezultojë e rrezikshme. Disa nga pasojat s'i kishit menduar fare.

VIRGJËRESHA
Një çështje financiare ju ka shqetësuar më shumë sesa që mendonit. Keni humbur fokusin edhe nga gjërat e rëndësishme.

PESHORJA
Keni dëshirë veç për udhëtime këtë periudhë. Koha dhe ritmi juaj e favorizojnë së tepërmi këtë dëshirë.

AKREPI
Jeni në mëdyshje të pranoni ose jo një marrëveshje të minutës së fundit. Mos u mendoni shumë sepse do të keni shumë favore.

SHIGJETARI
Partneri është bërë shumë kërkues karshi jush. Ka filluar t'ju bezdisë disi ky fakt.

BRICJAPI
Mos prisni që dita e sotme të ketë zhvillime për t'u mbajtur mend. Do të kalojë pa ndonjë situatë të rëndësishme.

UJORI
Keni filluar të ndryshoni mendim për një situatë të servirur nga të tjerët. Tani që po e përjetoni drejtpërdrejt ju duket krejt ndryshe.

PESHQIT
Dashuria do të zërë një vend të rëndësishëm gjatë ditës. Shumë vendime të shtyra sot do të marrin formë definitive.

Cardi B fal tradhtinë e bashkëshortit

Zënka mes çiftit Cardi B dhe Offset ka marrë fund. Reperja duket se ka falur tradhtinë e ish-bashkëshortit dhe është gati t'i japë një shans të dytë. "Cardi B është një person i fortë në pamje të jashtme, por nga brenda është shumë e ndjeshme. Ajo po lejon Offset t'i qëndrojë afër, por ka shumë kujdes. Offset i theu zemrën, por Cardi mendon ta bëjë sërish lidhjen të funksionojë dhe të dy po punojnë shumë për këtë gjë", ka thënë një burim pranë reperes për "HollywoodLife".

Chris Brown nis një histori të re dashurie



Ammika Harris ka qenë krahu i djathtë i Chris Brownit kur ai u përball me disa akuza për përdhunim. Lidhja e tij më e komentuar e reperit është ajo me Rihannën, e cila mori fund para disa vjetësh për shkak të dhunës fizike. Historia me Ammika Harris ka shkuar deri në veshin e Rihannës. Kjo e fundit nuk është shqetësuar aspak nga kjo romancë e re, madje është lumturuar. Ammika është një modele në "Instagram" që ka rreth 110 mijë ndjekës. Ajo është me prejardhje afro-amerikane dhe aziatike. Vëmendjen më të madhe e mori për shkak të lidhjes me Chrisin.



Supermodelueset Bella, Kendall dhe Hailey, në gjyq për mashtrim

Dy agjenci që përfaqësojnë supermodelueset si Bella Hadid, Kendall Jenner, Hailey Bieber dhe Emily Ratajkowski së shpejti do të detyrohen t'i zbulojnë detajet rreth pagesave që morën nga mashtruesi Billy McFarland për festivalin e dështuar të vitit 2017 'Fyre'. Yjet e pasarelave duhet t'i tregojnë informacionet që morën rreth pagesave për promovimin e festivalit. Administratori që mbikëqyr falimentimin e Fyre Media, i kërkoi një gjyqtari që të thërrasë në gjyq të famshmit që ndihmuan në promovimin e festivalit që u mbajt në Bahamas.

Këngëtarja bën tatuazh portretin e Harry Styles në faqe

Një këngëtare ka bërë një lëvizje drastike për ta tërhequr vëmendjen e yllit të popit, Harry Style. Kelsy Karter, nga Zelanda e Re, bëri tatuazh në faqe portretin e këngëtarit. Ajo publikoi fotografinë e tatuazhit në rrjetet sociale. "Më në fund e di se çfarë do t'i dhuroj Harryt për ditëlindjen e tij". Këngëtarja pati paralajmëruar në "Twitter" se kishte planifikuar diçka për ditëlindjen e Harryt më 1 shkurt.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	INTER - LAZIO	1	GIRONA - REAL MADRID	2	UNION BERLIN - KOLN	3+

Bytyqi: Kosova për shumë vjet e ka portën e sigurt

Trajneri i portierëve në Përfaqësuesen U15, Valmir Bytyqi, ka thënë se Kosova e ka portën e sigurt edhe për shumë vjet të tjera. "Portierët që ka Kosova aktualisht janë cilësorë, që nga Përfaqësuesja A e deri të grupmoshave. Mund të them se portën e kemi të sigurt edhe për shumë vjet të tjera", ka thënë Bytyqi, i cili i ka lavdëruar Arijanet Muriqin dhe Visar Bekajn, kurse ka treguar yllin e së ardhmes: Laurenc Shalën

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 JANAR - Ish-portieri i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll dhe i skuadrës së Besës nga Peja, Valmir Bytyqi, të mërkurën për "Epokën e re" ka thënë se Përfaqësuesja e Kosovës edhe për shumë vjet e ka portën e sigurt. "Portierët që ka Kosova aktualisht janë cilësorë, që nga Përfaqësuesja A e deri të grupmoshave. Mund të them se portën e kemi të sigurt edhe për shumë vjet të tjera", i cili më pas e ka lavdëruar portierin e Manchester Cityt, Arijanet Muriqi. "Është fat për ne që e kemi një portier si Muriqi dhe nëse ai nuk do të ketë ndonjë problem me lëndime apo ndonjë problem tjetër, atëherë do t'i sjell shumë siguri portës së Kosovës", ka shtuar ai.

Ish-portieri i njohur tash e disa muaj është angazhuar trajner i portierëve në grupmoshën U15 në Përfaqësuesen e Kosovës, ku ka vërejtur disa probleme që lidhen me talentët e rinj. "Në përfaqësuese jam që pesë muaj dhe për këtë kohë kemi arritur për se afërmi ta shikojmë dhe identifikojmë punën dhe cilësinë e portierëve si në vend, po ashtu edhe jashtë. Në muajin nëntor kishim një kamp në Gjermani e një në Zvicër ku u testuan shumë lojtarë dhe portierë. Mund të them se në Kosovë është një e metë e madh se në shumicën e shkollave dhe klubeve të futbollit mungojnë trajnerët e portierëve, rrjedhimisht pata talente që stagnojnë në ngitje të cilësisë dhe mbesin mbrapa me bashkëmoshataret e tyre jashtë Kosovës", ka thënë Bytyqi, duke shtuar: "Talenti nuk mungon dhe jam i bindur që Kosova në të gjitha grupmoshat ka portierë me perspektivë dhe me cilësi shumë të mira. Nuk dot kemi probleme as tash e as ne të ardhmen për përfaqësueset".

I pyetur se a ka ndonjë portier që në një të ardhme të afërt mund të jetë numër një në portën e Kosovës, por edhe në një klub të madh evropian, Bytyqi është përgjigjur: "Po, Kosova e ka një talent shumë premtues që është pjesë e skuadrës se West Ham Unitedit në grupmoshën U15. Është Laurenc Shala, i cili, nëse vazhdon me këtë përkushtim, jam i bindur që brenda katër apo pesë vjetësh do të jetë i gatshëm për Përfaqësuesen A dhe për një skuadër të madhe evropiane".

Në fund trajner Valmir Bytyqi ka lavdëruar edhe portierët aktualë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, duke thënë se ata janë duke bërë një punë të mirë nëpër skuadrat ku aktivizohen. "Për sa i përket Kosovës, mendoj se prin për nga cilësia Visar Bekaj i Prishtinës, por ka edhe disa portierë mjaft të mirë në Superligë që nuk kisha dashur t'i veçoj me emra, të cilët kanë krijuar një përvojë të mirë dhe po tregohen shumë të zotë në ekipet e tyre", ka përfunduar Bytyqi.

SHKURT

Besa mposhtet nga skuadra e Ligës së Dytë

Kriza e skuadrës së Besës së Pejës është konfirmuar edhe nga ndeshja miqësore e zhvilluar të mërkurën ndaj Dardanisë së Qyshkut. Pavarësisht se ishte një ndeshje miqësore, ekipi i Besës është mposhtur nga ekipi që bënë gara në një rang më të ulët. Skuadra që bënë gara në Ligën e Dytë, Grupi A, Dardania, e ka mposhtur skuadrën me traditë në futbollin e Kosovës, Besën (3-2). Golat për Dardaninë i shënuan Luigj Krasniqi, Lorik Kajtazi dhe Albin Gashi. Për skuadrën e Besës shënuan Lum Gashi dhe Florent Qorraj.

Drenica dhe Gjilani rikthehen në Kosovë

Skuadra e Drenicës dhe ajo e Gjilanit kanë përfunduar fazën përgatitore në Durrës dhe janë rikthyer në Kosovë. Skuadra nga Skenderaj, Drenica, ka njoftuar në faqen zyrtare se tash ekipi do t'i vazhdojë stërvitjet në Skenderaj, ndërkohë do ta shqyrtojë mundësinë të udhëtojë edhe një herë tjetër për herë të dytë në fazën përgatitore. Ndërsa Gjilani të mërkurën e ka mbajtur stërvitjen e fundit në Durrës, ku më pas është rikthyer në Kosovë, ku do ta vazhdojë fazën përgatitore për edicionin pranveror në Superligë.

Kukësi, shumë afër transferimit të Valdet Ramës

Afati kalimtar është drejt mbylljes, por Kukësi duket se nuk po ndalon duke afruar lojtarë. "Panorama Sport" raporton se ekipi verilindor është në negociata me Valdet Ramën, i cili ishte lojtar i Kombëtares shqiptare dhe është një goditje shumë e madhe për Kukësin nëse do të finalizohet. Prej 28 shkurtit të vitit që lamë pas është pa skuadër Rama, por 31-vjeçari ka një përvojë të madhe duke luajtur për shumë skuadra në Gjermani dhe për Valladollidin në Spanjë.

Guardiola: Këto tri klube janë më të mirat në dekadën e fundit

Pep Guardiola është pyetur se cilat janë skuadrat janë më të mira të dekadës së fundit dhe zgjedhjet e tij ngjallën shumë debate. "Tri skuadrat më të mira të dekadës së fundit janë: Juventusi, Bayern Muncheni dhe Barcelona. Pse? Sepse çdo sezon fitojnë kampionatin, sepse çdo sezon fitojnë Kupën dhe çdo sezon janë aty duke konkurruar. Për këtë arsye janë më të mirët", ka thënë Guardiola, i cili la jashtë kësaj liste Real Madridin që në pesë sezonet e fundit ka fituar katër herë Ligën e Kampionëve.

Kosova - Danimarka përballen më 21 mars në "Fadil Vokrri"

PRISHTINË, 30 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të zhvillojë ndeshje miqësore ndaj Kombëtares së Danimarkës më 21 mars në Prishtinë. Lajmi është konfirmuar nga Federata e Futbollit e Kosovës. "Kosova do të luajë miqësore me Kombëtaren e Danimarkës më 21 mars. Finalizimin e marrëveshjes së kësaj miqësoreje ndërmjet dy federatave e ka konfirmuar presidenti Agim Ademi. Kjo ndeshje zhvillohet në stadiumin 'Fadil Vokrri' në Prishtinë dhe vjen katër ditë para se 'Dardanët' ta nisin ciklin kualifikues për 'Euro 2020' kundër Bullgarisë", thuhet në njoftimin e FFK-së.

Debutim ëndrrash për Mavrajn

Ingolstadt, 30 janar - Vlerësime pozitive për Mergim Mavrajn, që debutimin e tij me FC Ingolstadt 04 e ka bërë si një lider. Qendërmbrojtësi i kombëtares është vlerësuar më i miri i ndeshjes, teksa nota për të ka qenë 2.5. Një notë mjaft e lartë, duke ditur mënyrën se si bëhen vlerësimet në Gjermani. "Shqiptari debutoi me Ingolstadt dhe e bëri në nivel të lartë. 32-vjeçari nuk bënte kompromise në duelet me kundërshtarët, bëri ndërhyrjet e duhura dhe mori rolin e liderit. Me fat, ai arriti ta fitonte edhe penalltinë që i dha fitoren Ingolstadtit", shkruan "donaukurier.de". Mavraj konsiderohet më i miri në fushë edhe nga "whoscored.com". Referuar paraqitjes së tij, ai ka marrë notën 8.6. Një nisje shumë e mirë për qendërmbrojtësin, madje ndaj ish-skuadrës së tij Greuther Further.

Zeneli: Kosovën e zgjodha me zemër

Arbër Zeneli është një nga më meritoret për suksesin historik të Kosovës në Ligën e Kombeve. Tash e tutje ylli "dardan" do të luajë në kampionatin elitar të Francës

Prishtinë, 30 janar - Reprezentuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Arbër Zeneli, në një intervistë për klubin e vet të ri, Stade de Reims, ka treguar se e zgjodhi Kosovën me zemër. Zeneli preferoi t'i mbrojë ngjyrat e vendit të prejardhjes para vendit ku ka lindur, Suedisë. "E zgjodha Kosovën me zemër sepse prindërit e mi vijnë nga Kosova dhe, edhe pse unë nuk kam lindur atje, prapëseprapë kam gjak kosovari. Unë jam shumë i lidhur me rrënjët e mia dhe mendoj se mora vendimin e duhur dhe jam krenar që jam pjesë e këtij ekipi", ka thënë Zeneli në faqen zyrtare të skuadrës franceze. Zeneli debutoi për Kosovën më 6 tetor të vitit 2016, menjëherë pasi vendi u pranua në UEFA dhe FIFA. 23-vjeçari ka kaluar nëpër tri ekipe kombëtare të Suedisë: U-17, U-19 dhe U-21. Me këtë të fundit, Zeneli edhe e fitoi Kampionatin Evropian U-21. Ai e shënoi një gol në 10 paraqitje. "Po, ka qenë e vështirë për mua, sepse isha pjesë e ekipit që e fitoi Kampionatin Evropian U-21 dhe pas kësaj ndjeva se deshën të ma jepnin një rast por, në fakt, nuk ma dhanë asnjëherë", ka deklaruar Zeneli.

Spurs fiton në fund, Lakersi mposhtet nga Philadelphia

Los Angeles, 30 janar - Surpriza në ndeshjet e NBA-s, me Lakersin që u mund 121-105 në fushën e vet nga Philadelphia. Ingrami realizoi 36 pikë për kalifornianët, por që mbetën për statistikë, ndërsa për miqtë u dallua Embiid me 28 pikë e 11 rebounde, mbështetur edhe nga Butleri me 20 pikë. Humbet edhe skuadra e Houstonit, që u mund në fushën e vet nga New Orleans 121-116.

